



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK)
Bolnička i Klinička Univerziteteska Sluzba Kosova (BKUSK)
The Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)

Menaxhimi me pandeminë COVID-19 në ShSKUK

Raport për vitin 2021

Përgatitur nga
Dr. Valbon Krasniqi
Drejtor i Përgjithshëm i ShSKUK-së

Mars 2022

Përmbajtja:

Hyrje	3
Aktivitetet Specifike për menaxhimin e pandemisë COVID-19	5
1. Sigurimi i stafit shëndetësorë të mjaftueshëm përmes riorganizimit të stafit ekzistues dhe angazhimit të stafit shtesë për COVID-19	5
2. Zgjerimi i kapaciteteve infrastrukturore për të siguruar shtretër të mjaftueshëm për trajtimin klinik të pacientëve të sëmurë nga COVID-19	7
A. Kapacitetet me shtretër në QKUK	8
A1: Klinika Infektive.....	8
A2: Mjekësia Sportive dhe Fizikale me Rehabilitim	9
A3: Klinika e Pulmologjisë dhe Dermatovenerologjisë	10
A4: Blloku i Klinikave Internistike.....	10
A5: MIQ (Mjekimi Intensiv Qendror)	10
B. Kapacitetet me shtretër në Spitalet e Përgjithshme	11
Tabela B1: Kapacitetet me shtretër në SP në Gjilan	11
Tabela B2: Kapacitetet me shtretër në SP në Prizren	11
Tabela B3: Kapacitetet me shtretër në SP në Gjakovë	12
Tabela B4: Kapacitetet me shtretër në SP në Pejë	12
Tabela B5: Kapacitetet me shtretër në SP në Mitrovicë, Vushtri dhe Ferizaj	12
3. Sigurimi i paisjeve mjekësore të nevojshme për njësitë përbërëse të ShSKUK.....	13
Donacionet e dedikuara për COVID-19 gjatë vitit 2021 (tabela 3.1)	14
4. Furnizimi me barëna dhe material shpenzues mjekësor	18
5. Furnizimi me paisje mbrojtëse personale për stafin shëndetësorë dhe teknik-mbështetës	22
6. Furnizimi me dezinfektues dhe dezinfektimi i rregullt i ambienteve / hapësirave spitalore në Klinikat / Repartet COVID-19.....	24
Pandemia COVID-19 gjatë vitit 2021 në Kosovë	26
Vala e pandemisë COVID-19 gjatë muajit Mars-Prill 2021.....	33
Vala e pandemisë COVID-19 gjatë muajit Gusht-Shtator 2021.....	37
Plani i veprimit për shtimin e numrit të shtretërve për trajtimin e pacientëve COVID-19 në valën e muajit Gusht-Shtator 2021	39
I.Kapacitetet spitalore me shtretër në ShSKUK, Faza-I-	39
II.Kapacitetet spitalore me shtretër në ShSKUK, Faza-II-	39
III. Kapacitetet spitalore me shtretër në ShSKUK, Faza-III-	40
Pacientët e trajtuar me COVID-19 sipas muajve dhe njësive të ShSKUK gjatë vitit 2021	43
Vdekjet nga COVID-19 në Kosovë.....	44
Aktivitetet e Komitetit të ShSKUK për ngritjen e gatishmërisë për menaxhimin e rasteve klinike me COVID-19 në nivel të ShSKUK-së	46
Sfidat kryesore në menaxhimin e pandemisë COVID-19 në ShSKUK	54
Falënderim.....	55

HYRJE

Shpërthimi i pandemisë COVID-19 shkatuar nga një virus i familjes së koronavirusëve (SARS COV-2) gjatë vitit 2020 ishte një situatë e pa përjetuar më parë në mbarë globin. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) dhe autoritetet e shëndetit publik në të gjithë botën ndërmorën masa për të ngadalësuar përhapjen e COVID-19 dhe për të zvogëluar shkallën e infektimit. Qeveritë e vendeve të ndryshme u detyruan të zbatojnë një sërë politikash dhe masash, duke përfshirë mbylljen e kufijve, karantinat e detyrueshme, kufizimet e lëvizjes, ndalimet e tubimeve të mëdha, kufizimin e lëvizjeve jashtë shtetit, gjë që solli ndryshime të mëdha në jetën e përditshme dhe në veprimtarinë e biznesit. Edhe Kosova u detyrua që të ndërmarrë shumicën e masave të njëjta në përballje me pademinë COVID-19.

Me qëllim të menaxhimit efikas të pandemisë dhe ofrimit të shërbimeve shëndetësore cilësore për pacientët e sëmurë me COVID-19 që kërkojnë trajtim spitalor, ShSKUK ka hartuar planin për menaxhimin klinik të rasteve me COVID-19 për vitin 2021 i cili përfshinë masat e përgjithshme dhe specifike për trajtimin klinik të rasteve spitalore; në mënyrë të veçantë përfshinë 6 aktivitete specifike, si në vijim.

1. Sigurimi i personelit shëndetësor të mjaftueshëm përmes riorganizimit të stafit ekzistues dhe angazhimit të stafit shtesë për COVID-19;
2. Zgjerimi i kapaciteteve infrastrukturore për të siguruar shtretër të mjaftueshëm për trajtimin klinik të pacientëve të sëmurë nga COVID-19
3. Sigurimi i paisjeve mjekësore të nevojshme për njësitë përbërse të ShSKUK-së
4. Furnizimi me barna dhe material shpenzues mjekësor
5. Furnizimi me paisje mbrojtëse personale (PPE) për personelin shëndetësorë dhe atë teknik-mbështetës;
6. Furnizimi me dezinfektues dhe dezinfektimi i rregullt i ambienteve / hapësirave spitalore në Klinikat /Repartet COVID-19.

Plani është hartuar duke u bazuar në resurset në njerëz, në infrastrukturë, në paisje mjekësore dhe teknologjike, barna dhe material shpenzues, në përvojën e fituar tashmë nga viti paraprak, në buxhetin e ndarë për njësitë përbërëse të ShSKUK-së, të cilët janë vlerësuar nga Komiteti për ngritjen e gatishmërisë për COVID-19 në ShSKUK, me qëllim ndërmarrjen e masave të nevojshme për kontrollin e infeksionit COVID-19, menaxhimin dhe trajtimin e të sëmurëve nga COVID-19.

Në këtë raport mbi menaxhimin klinik të pacientëve me COVID-19 janë paraqitur kapacitetet spitalore të planifikuara (në shtretër), resurset në njerëz, paisjet mjekësore, furnizimi me barëna dhe material medicinal shpenzues si dhe PPE (Paisjet mbrojtëse për personelin shëndetësorë). Në mënyrë të veçantë raporti paraqet investimet strategjike më të rëndësishme dhe jetëshpëtuese

lidhur me menaxhimin e Pandemisë COVID-19: ndryshimin e sistemit të furnizimit me oksigjen për Spitalet e Përgjithshme dhe QKUK nga forma e furnizimit me oksigjen të gazët përmes bombolave - në formën e furnizimit me oksigjen të lëngshëm, përmes dy projekteve kapitale:

- ✚ Instalimit të rezervuarëve të oksigjenit në Spitalet e Përgjithshme dhe në QKUK, dhe;
- ✚ Zgjerimit të rrjetit të sistemit qendror të oksigjenit në klinikat e QKUK-së.

Në raport është paraqitur edhe një analizë mbi numrin e përgjithshëm të pacientëve me COVID-19 të trajtuar në Klinikat e QKUK-së dhe në Spitalet e Përgjithshme, numrin e pacientëve me COVID-19 të trajtuar në njësitë e kujdesit intenziv, numrin e pacientëve të vdekur nga COVID-19 si dhe analizën mbi shkallën vdekshmërisë nga COVID-19 në Kosovë, krahasuar me vendet e rajonit dhe me disa nga vendet e Bashkimit Evropian, SHBA-së, dhe Anglisë. Në raport poashtu janë të përmbledhura aktivitetet kryesore të ndërmarra në nivel të Komitetit për ngritjen e gatishmërisë për COVID-19 në ShSKUK.

Gjatë vitit 2021 Kosova u ballafaqua me 2 valë të Pandemisë COVID-19; njëren gjatë muajit Mars-Prill dhe tjetrën gjatë muajit Gusht-Shtator 2021. Kjo e fundit ishte vala më e ashpër që nga fillimi i Pandemisë, duke arritur numrin më të lartë të të spitalizuarve – pikun me rreth 1,300 të spitalizuar në fund të muajit Gusht 2021.

AKTIVITETET SPECIFIKE PËR MENAXHIMIN E PANDEMISË COVID-19

1. Sigurimi i personelit shëndetësor të mjaftueshëm përmes riorganizimit të stafit ekzistues dhe angazhimit të stafit shtesë për COVID-19;

Bazuar në vendimin e Qeverisë së Kosovës të datës 05/07/2020 për riorganizimin e personelit shëndetësorë në funksion të ofrimit të shërbimeve shëndetësore për pacientët e sëmurë nga COVID-19, ShSKUK ka ndërmarrë veprimet e nevojshme në këtë drejtim. Krahas Klinikës Infektive si klinikë bazë që trajton pacientët me COVID-19, sikurse gjatë vitit paraprak, edhe gjatë vitit 2021 është paraqitur nevoja për riorganizimin e stafit nga klinikat tjera të QKUK-së dhe të SP. Riorganizimi i personelit shëndetësorë nga klinikat/dhe repartet tjera në nivel të ShSKUK-së është bërë në formë të rotacionit me angazhimin e shumicës së personelit nga klinikat dhe repartet tjera nëpër klinikat dhe repartet ku janë trajtuar pacientët COVID-19. Gjatë riorganizimit të stafit shëndetësorë në këtë mënyrë janë realizuar trajnime sipas nevojës, përfshirë trajnime në kuadër të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional (EVP), (foto 1) por edhe trajnimet gjatë punës (“on-job training”) (foto 2); kjo formë e trajnimeve është realizuar në atë mënyrë që personeli shëndetësorë (mjekë dhe infermierë) nga klinikat tjera kanë punuar si pjesë e ekipeve të përbashkëta shëndetësore të përbërë nga mjekë dhe infermierë tashmë me eksperiencë të fituar në trajtimin e pacientëve të prekur me COVID-19.

Foto 1. Trajnime të personelit shëndetësorë në kuadër të EVP



Foto 2. Trajnime gjatë punës (on job training)



Krahas riorganizimit dhe angazhimit të personelit shëndetësorë ekzistues nga klinikat dhe repartet tjera, një numër i personelit (rreth 150) është siguruar nga mbështetja e MSh përmes rekrutimit të profesionistëve shëndetësorë, kryesisht staf infermior dhe stafit mbështetës bazuar në Ligjin nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19. Kështu, gjatë

valës së muajit Mars-Prill 2021 përmes riorganizimit të personelit ekzistues dhe rekrutimit të stafit shtesë, numri i përgjithshëm i profesionistëve shëndetësorë dhe stafit mbështetës të kyqyr drejtëpërdrejtë në trajtimin e pacientëve të prekur me COVID-19 në QKUK dhe në SP kalon shifrën mbi dy mijë.

Tabela 1.1. Numri i profesionistëve shëndetësorë dhe stafit mbështetës në përkujdesje ndaj pacientëve me COVID-19 në QKUK dhe në SP gjatë valës së muajit Mars-Prill 2021

	QKUK	Spitalet e Përgjithshme	Gjithsej
Mjek	211	450	661
Infermier	368	734	1,102
Mjek në specializim	31	20	51
Staf mbështetës	54	161	215
Gjithsej	664	1,365	2,029

Nga numri i përgjithshëm i stafit të angazhuar në trajtimin e pacientëve me COVID-19, gjatë valës së muajve Mars-Prill është 1,365 (apo 67%) janë angazhuar në Spitalet e Përgjithshme ndërsa në QKUK 664 (apo rreth 33%).

Sipas profileve 1,102 janë infermier/e, 661 mjek dhe 215 staf mbështetës teknik.

Gjatë valës së fundit të paraqitur gjatë muajve Gusht-Shtator 2021, MSh ka arritur që për nevojat e ShSKUK-së të angazhojë rreth 750 personel shtesë (prej tyre 600 profesionistë shëndetësorë dhe 150 staf mbështetës) për trajtimin e pacientëve me COVID-19, gjë që ka qenë një lehtësim i madh për ShSKUK-në në këtë fushë (shih tabelën e mëposhtme). Ky staf shtesë ka qenë në dispozicion për ShSKUK-në nga java e parë e muajit Shtator 2021.

Tabela 1.2. Angazhimi i profesionistëve shëndetësorë shtesë nga MSh për nevojat e ShSkUK-së për trajtimin e pacientëve me COVID-19.

Njësia	Infermier bachelor	Ndihmës Infermier	Teknik Rentgenit	Teknik Laborant	Gjithsej
QKUK	130	120	20	20	290
SP Prizren	35	24	5	2	66
SP Mitrovicë	20	10	2	2	34
SP Vushtrri	10	6	4	4	24
SP Gjakovë	30	15	4	4	53
SP Pejë	25	15	6	2	48
Sp Ferizaj	20	5	4	3	32
SP Gjilan	30	15	4	4	53
Gjithsej	300	210	49	41	600

ShSKUK gjatë vitit 2021 është përballur me dy sfida të mëdha për sa i përket sigurimit të mjaftueshëm të profesionistëve shëndetësorë dhe stafit mbështetës për trajtimin e pacientëve me COVID-19;

- E para, nevojat e larta, sidomos për infermierë pothuasje dy-fish më shumë se sa për të sëmurët tjerë: kjo për faktin se pacientët e sëmurë nga COVID-19 kanë nevojë për përkujdesje infermierore të vazhdueshme 24 orëshe nga njëra anë, dhe nga ana tjetër nevojitet ndrrim/ pushim i shpeshtë i infermierëve për shkak të angazhimit të vazhdueshëm si dhe për shkak të nevojës për veshmbathje me paisje mbrojtëse personale (PPE) për t'u mbrojtur nga infeksioni COVID-19.
- E dyta, infeksionet e stafit shëndetësorë dhe atij mbështetës kanë bërë që një numër i konsiderueshëm i tyre të largohen përkohësisht nga trajtimi i pacientëve të prekur me COVID-19. Kjo ishte sidomos sfidë gjatë valës së muajit Mars-Prill, ndërkohë që gjatë valës së muajit Gusht-Shtator 2021 numri i personelit shëndetësorë të infektuar ishte simbolik, pasi tashmë shumica e të punësuarve në ShSKUK ishin vaksinuar me dy doza të vaksinës kundër COVID-19.

Pandemia COVID-19 ka vënë në pah nevojën e ndërtimit të një sistemi shëndetësorë që mund të ri-organizohet shpejtë dhe të adaptohet për t'iu përgjigjur nevojave emergjente shëndetësore. Në mënyrë të veçantë, ShSKUK ka nevojë për shtimin e stafit infermior dhe shtimin e kapaciteteve të shërbimeve teknike-mbështetëse.

2. Zgjerimi i kapaciteteve infrastrukturore për të siguruar shtretër të mjaftueshëm për trajtimin klinik të pacientëve të sëmurë nga COVID-19

Vala COVID-19 gjatë muajve Mars-Prill 2021

Duke pasur parasysh përvojën nga viti i kaluar, ShSKUK me kohë ka përgatitur planin e veprimit për rritjen e numrit të shtretërve që do të jenë në dispozicion për trajtimin klinik të pacientëve me COVID-19. Me përjashtim të objektit të Qendrës së MFRMS (Mjekësia Fizikale me Rehabilitim dhe Mjekësia Sportive) që ka rreth 100 shtretër shtesë në dispozicion, të gjithë shtretërit tjerë sigurohen përmes ridestinimit – riorganizimit të klinikave të QKUK-së dhe reparteve të SP. Kështu, numri i shtretërve të planifikuar për trajtimin klinik të pacientëve COVID-19 për këtë fazë në nivel të ShSKUK-së është mbi 1,150 shtretër, prej të cilëve rreth 450 shtretër në QKUK dhe 720 në Spitalet e Përgjithshme. Numri i shtretërve në njësitë e mjekimit intensiv në nivel të ShSKUK-së gjithsej është planifikuar të jetë 72 (26 shtretër në MIQ, 6 në Klinikën Infektive dhe 40 në SP).

Tabelat në vijim paraqesin në detaje numrin e shtretërve në dispozicion sipas reparteve, klinikave dhe spitaleve të përgjithshme.

A: OKUK**A1: KLINIKA INFEKTIVE**

Numri i shtretërve në dispozicion në Klinikën Infektive gjithsej është 122; prej tyre 42 shtretër të kyqur në rrjetin qendror të oksigjenit (36 shtretër në reparte dhe 6 shtretër në njësinë e mjekimit intensiv). Gjatë tremujorit të parë 2021 është implementuar projekti i zgjerimit të rrjetit të sistemit qendror të oksigjenit ku janë kyqur në këtë sistem edhe 68 shtretër, kështu që Klinika Infektive tashmë ka në dispozicion 110 shtretër të kyqur në rrjetin e sistemit qendror të oksigjenimit.

Tabela A1. Kapacitetet me shtretër në Klinikën Infektive

Repartet	Nr i shtretërve				
	Me O2 qendror	Zgjerimi me O2 qendror	Gjithsej me O2 qendror	Pa O2	Gjithsej Shtretër
Reparti A	6	10	16	2	18
Reparti B	6	14	20	2	22
Reparti C	6	14	20	2	22
Reparti D	6	14	20	2	22
Reparti E	6	08	14	2	16
Reparti F	6	08	14	2	16
Intensive	6	-	06	-	06
Gjithsej	42	68	110	12	122

A2: MJEKËSIA FIZIKALE ME REHABILITIM DHE MJEKËSIA SPORTIVE (COVID II)

Numri i shtretërve në dispozicion në objektin e Mjekësisë Fizikale me Rehabilitim dhe Mjekësi Sportive (Njësinë COVID II) në gjithsej është 97, dhe të gjithë shtretërit janë të kyqur në sistemin e oksigjenit qendror. Gjatë fundvitit 2020 janë bërë investime në përf forcimin e sistemit qendror dhe të gjithë shtretërit janë në dispozicion me kapacitete të plota në rrjetin e sistemit qendror të oksigjenit.

Tabela A2. Kapacitetet me shtretër në Njësinë COVID II (Mjekësia Fizikale me Rehabilitim dhe Mjekësia Sportive)

Repartet	Nr i shtretërve				
	Me O2 qendror	Zgjerimi me O2 qendror	Gjithsej me O2 qendror	Pa O2	Gjithsej Shtretër
Kati 1	14	-	14	-	14
Kati 2	52	-	52	-	52
Kati 3	32	-	32	-	32
Gjithsej	97	-	97	-	97

A3: KLINIKA E PULMOLOGJISË DHE DERMATOVENEROLOGJISË

Numri i shtretërve në dispozicion në Klinikën e Pulmologjisë dhe Dermatovenerologjisë gjithsej është 88, prej tyre 36 shtretër të kyqur në sistemin e oksigjenit qendror. Kjo Klinikë furnizohet me oksigjen të lëngshëm nga një cryo-tank me kapacitet prej 5 ton oksigjen të lëngshëm (i njëjti furnizon me oksigjen edhe Klinikën e Gjinekologjisë). Për shkak të vjetërsisë së tij, ky cryo-tank është zëvendësuar me një cryo-tank të ri me kapacitetet prej 10 ton; ndërkohë gjatë gjysmës së parë të vitit 2021 është bërë edhe zgjerimi i rrjetit qendror të sistemit të oksigjenimit duke kyqur në këtë sistem edhe 52 shtretër, duke çuar kështu numrin e kyqur të shtretërve në oksigjen qendror në këtë klinikë në gjithsej 88 shtretër.

Tabela A3. Kapacitetet me shtretër në Klinikën e Pulmologjisë dhe Dermatovenerologjisë

Repartet	Nr i shtretërve				
	Me O2 qendror	Zgjerimi me O2 qendror	Gjithsej me O2 qendror	Pa O2	Gjithsej Shtretër
Klinika e Pulmologjisë				0	66
Klinika e Dermatovenerologjisë				6	28
Gjithsej	36	52	88	6	94

A4: BLOKU I KLINIKAVE INTERNISTIKE

Numri i shtretërve në dispozicion në Klinikat e Bllokut Internistik (Njësia COVID III) gjithsej është 112, prej tyre 70 shtretër të kyqur në sistemin e oksigjenit qendror. Këto klinika furnizohen me oksigjen të lëngshëm nga cryo-tanku me kapacitet prej 20 Ton oksigjen të lëngshëm (përveq klinikave internistike, ky cryo-tank furnizon me oksigjen edhe Klinikën e ORL, Oftalmologjisë, Klinikat Kirurgjike, Klinikën Emergjente, Mjekimin Intensiv Qendror dhe Klinikën e Infektivës). Cryo-tanku është dhënë në shfrytëzim pro-bono nga kompania Medical-Group në muajin Gusht 2020 me ç'rast ka mundur që cryo-tanku i QKUK me kapacitet prej 10 T të zhvendoset dhe është dërguar në SP të Prizrenit. ShSKUK ka instaluar rezervoarin e ri prej 20 ton në QKUK gjatë fund vitit 2021. Poashtu edhe në këto klinika gjatë vitit 2021 është bërë zgjerimi i rrjetit qendror të oksigjenit ku janë kyqur edhe 20 shtretër shtesë në sistemin qendror.

Tabela A4. Kapacitetet me shtretër në Njësinë COVID III (Klinikat e Bllokut Internistik)

Repartet	Nr i shtretërve				
	Me O2 qendror	Zgjerimi me O2 qendror	Gjithsej me O2 qendror	Pa O2	Gjithsej Shtretër
Klinika e Gastroenterologj.	-	-	-	-	33
Klinika e Endokrinologjisë	-	-	-	-	33
Kl. e Hematol.&Nefrologj.	-	-	-	-	46
Gjithsej	70	42	112	-	112

A5: MJEKIMI INTENSIV QENDROR (MIQ)

Numri i shtretërve në dispozicion në Njësine e Kujdesit Intesiv (MIQ COVID) është 26, dhe të gjithë shtretërit janë të kyqur në oksigjen qendror. Gjatë muajit Nëntor 2020 janë bërë investime në përfocimin e rrjetit të sistemit qendror të oksigjenit dhe të gjithë shtretërit janë në dispozicion për shfrytëzim në sistemin qendror të oksigjenit. Deri para këtij përforcimi, nga 26 shtretër mund të shrytëzoheshin vetëm 12-14 shtretër për shkak të furnizimit me presion të pamjaftueshëm të oksigjenit për këtë njësi. MIQ COVID furnizohet me oksigjen të lëngshëm nga cryo-tanku me kapacitet prej 20 ton oksigjen të lëngshëm. (përveq MIQ, ky cryo-tank furnizon me oksigjen edhe Klinikat e bllokut internistik, Klinikën e ORL, Oftalmologjisë, Klinikat kirurgjike Klinikën Emergjente dhe Klinikën e Infektivës).

Tabela A5. Kapacitetet me shtretër në Njësine e Kujdesit Intesiv (MIQ COVID)

Repartet	Nr i shtretërve				
	Me O2 qendror	Zgjerimi me O2 qendror	Gjithsej me O2 qendror	Pa O2	Gjithsej Shtretër
Kujdesi Intesiv	26	-	26	-	26
Gjithsej	26	-	26	-	26

QKUK: Tabela A. Kapacitetet me shtretër në Klinikat e QKUK (të gjitha Klinikat COVID)

Klinikat	Nr i shtretërve					
	Me O2 qendror	Zgjerimi me O2 qendror	Pa O2	Intenzive O2 qendror	Gjithsej me O2 qendror	Gjithsej Shtretër
Klinika Infektive	36	68	12	6	110	122
COVID II (MFRMS)	98	-	-	-	98	98
Kl. Pulmo&Dermato.	36	52	6	-	88	94
COVID III (Kl. Interne)	70	42	-	-	112	112
MIQ COVID	-	-	-	26	26	26
Gjithsej	240	162	18	32	434	452

B: SPITALET E PËRGJITHSHME

Bazuar në përvojën nga viti 2021, shtatë (7) Spitalet e Përgjithshme kanë hartuar planet e tyre të veprimtimit për menaxhimin e rasteve klinike me COVID-19, mvarësisht nga projeksionet për shtimin – ridestinimin e shtretërve sipas nevojave. Spitalet e Përgjithshme për valën e muajit Mars-Prill 2021 kanë vënë në dispozicion gjithsej 720 shtretër, prej të cilëve 40 për mjekim intenziv për pacientët që eventualisht kanë nevojë për respiratorë. Në përgjithësi, të gjitha SP fillimisht kanë ridestinuuar në reparte për COVID kapacitetet e tyre në repartet infektive, pastaj atyre të pulmologjisë, për të vazhduar me repartet internistike. Për shkak të numrit më të vogël të shtretërve në dispozicion –kapaciteteve tejet të limituara, SP në Vushtri dhe SP në Ferizaj janë detyruar që të hartojnë plane për shfrytëzimin pothuasje të tërë kapaciteteve të tyre duke ruajtur vetëm shërbimet emergjente dhe ato më esenciale. Madje, disa nga SP, siq është rasti me SP në Ferizaj, dhe në Pejë, disa nga hapësirat e stafit shëndetësorë dhe sallat e takimeve të mjekëve janë furnizuar me shretër dhe janë shndërruar në dhoma për trajtimin e pacientëve COVID-19. Tabelat në vijim paraqesin numrin e shtretërve në dispozicion sipas spitaleve dhe reparteve.

Tabela B1. Kapacitetet me shtretër në SP në Gjilan

SP Gjilan	Nr i shtretërve				
Repartet	Me O2 qendror	Zgjerimi me O2 qendror	Gjithsej me O2 qendror	Pa O2	Gjithsej Shtretër
Infektive	8	-	8	20	28
Pulmo	11	-	11	9	20
Neurologji	11	-	11	0	11
ORL	6	-	6	9	15
Kirurgji	9	-	9	14	23
Interno	10	-	10	15	25
Kujdes Intenziv*	8	-	8	0	8
Gjithsej	63	-	63	67	130

* Njësia koronare shndërrohet në repart të kujdesit intenziv për COVID-19

Tabela B2. Kapacitetet me shtretër në SP në Prizren

SP Prizren	Nr i shtretërve				
Repartet	Me O2 qendror	Zgjerimi me O2 qendror	Gjithsej me O2 qendror	Pa O2	Gjithsej Shtretër
Infektive	33	-	33	3	36
Pulmo	49	-	49	0	49
Neurologji	20	-	20	0	20
Pediatrik	42	-	42	0	42
Kujdesi Intenziv	14	-	14	0	14
Gjithsej	158	-	158	3	161

Tabela B3. Kapacitetet me shtretër në SP në Gjakovë

SP Gjakovë	Nr i shtretërve				
Repartet	Me O2 qendror	Zgjerimi me O2 qendror	Gjithsej me O2 qendror	Pa O2	Gjithsej Shtretër
Infektive	4	-	4	17	21
Pulmo	10	-	10	14	24
Internistik	12	-	12	36	48
Neurologji	10	-	10	14	24
Dermatologji	1	-	1	5	6
Kujdes Intenziv*	12	-	12	0	12
Gjithsej	49	-	49	86	135

* Njësia koronare shndërrohet në repart të kujdesit intenziv për COVID-19

Tabela B4. Kapacitetet me shtretër në SP në Pejë

SP Pejë	Nr i shtretërve				
Repartet	Me O2 qendror	Zgjerimi me O2 qendror	Gjithsej me O2 qendror	Pa O2	Gjithsej Shtretër
Infektive	5	-	5	11	16
Pulmo	31	-	31	23	54
Internistik	30	-	30	12	42
Neurologji	31	-	31	0	31
Psikiatrik	2	-	2	16	18
Kujdes Intenziv	6	-	6	0	6
Gjithsej	105	-	105	62	167

Tabela B5. Kapacitetet me shtretër në SP - Mitrovicë, Vushtri dhe Ferizaj

SP	Nr i shtretërve				
Spitali	Me O2 qendror	Zgjerimi me O2 qendror	Gjithsej me O2 qendror	Pa O2	Gjithsej Shtretër
Mitrovicë	0	-	0	26	16
Vushtri	28	-	28	28	28
Ferizaj	07	-	7	66	73
Gjithsej	35	-	35	120	155

SP: Tabela B. Kapacitetet me shtretër në Spitalet e Përgjithshme (të gjitha SP)

Spitalet e Përgjithshme	Me O2 qendror	Zgjerimi me O2 qendror	Pa O2	Intenzive O2 qendror	Gjithsej me O2 qendror	Gjithsej Shtretër
SP Prizren	144	-	3	14	158	161
SP Gjilan	55	-	67	08	63	130
SP Gjakovë	37	-	86	12	49	135
SP Pejë	99	-	62	6	105	167
SP Ferizaj	7	-	66	0	7	73
SP Mitrovicë	0	-	26	0	0	26
SP Vushtri	28	-	0	0	28	28
Gjithsej	370		310	40	410	720

ShSKUK:Tab. A/B. Kapacitetet me shtretër të destinuar për COVID-19 në ShSKUK

ShSKUK	Me O2 qendror	Zgjerimi me O2 qendror	Pa O2	Intenzive O2 qendror	Gjithsej me O2 qendror	Gjithsej Shtretër
QKUK	240	162	18	32	434	452
Spitalet e Përgjithshme	370	-	310	40	410	720
Gjithsej	610		328	72	844	1,172

3. Sigurimi i paisjeve mjekësore të nevojshme për njësitë përbërse të ShSKUK-së.

ShSKUK ka arritur që të sigurojë numër optimal të paisjeve mjekësore të nevojshme për klinikat dhe spitalet të cilat trajtojnë pacientët e prekur nga COVID-19. Duhet theksuar se një pjesë e madhe e paisjeve mjekësore janë siguruar përmes donacioneve nga donatorët ndërkombëtarë.

ShSKUK gjatë vitit 2021 ka arritur të ketë në dispozicion 150 ventilatorë (respiratorë) të rinjë vetëm për trajtimin e pacientëve nga COVID-19, qindra monitorë për monitorimin e shenjave vitale të pacientëve, për secilën klinikë dhe secilin SP është siguruar të paktën nga një aparat i rentgenit mobil, në disa spitale edhe rentgena të rinjë statik, poashtu është siguruar një CT aparat për Spitalin e Gjakovës dhe shumë pajse e material shpenzues për këto pajisje.

Poashtu është përmirësuar edhe diagnostika laboratorike, për secilën klinikë dhe repart ku trajtohen pacientët e prekur nga COVID-19 janë siguruar aparate për analiza hematologjike dhe biokimike, aparate për analizat gazore (statusi acido-bazik), dhe reagensa për analiza të specifike për COVID-19 siq është psh.D-dimeri.

Tabela e mëposhtme paraqet llojin, sasisnë, donatorin dhe shpërndarjen e donacioneve për COVID-19 në njësitë e ShSKUK-së.

Tabela 3.1. Donacionet e dedikuara për COVID-19 gjatë vitit 2021

Donacionet COVID-19 (produkte dhe paisje mjekësore) - Viti 2021

Nr. rend.	Donatori	Emërtimi	Sasia	Çmimi për njësi	Gjithsej	Institucioni
1	OBSH dhe Ambasada Gjermane	Fingertip pulse oximeter	5,000	16.28	81,400.00	QKUK dhe Spitale Rajonale
		Ventilator Trilogy EVO 02	60	17,739.62	1,064,377.20	
		Ventilator PrismaVent 50-C	140	7,350.00	1,029,000.00	
2	Community Development Fund – CDF	Medical/surgical mask/ three layers	1,180	0.10	118.00	SHSKUK
		Respirator (FFP2/N95)	7,100	2.18	15,478.00	
		Gloves, examination (piece, not pair)	185	0.08	14.80	
		Alcohol-based hand rub, bottle 1000ml	730	3.40	2,482.00	
		Multiuse masks (textile)	0	0.00	0.00	
		Shoe covers Package (pack of 100 pieces)	310	1.90	589.00	
		Disposable protective cover all with elastic cuffs, attached hood and boots	2,150	4.15	8,922.50	
3	Aksioni për Nëna dhe Fëmijë - AMC dhe KOSTT	Dorëza PVC latex (madhësia: M)	50 pako	7.80	390.00	Klinika Obstetrike Gjinekologj.
		Dorëza PVC latex (madhësia: L)	10 pako	7.80	78.00	
		Maska Surgical	48	3.20	153.60	
		Alkool 70%	99	1.85	183.15	
		Dezinfektues për duar	100	1.95	195.00	
4	NLB Banka	CPAP maska (madhësia M dhe L)	100	16.20	1,620.37	Klinika e Anesteziol.
		Katetera për aspirim traheal me sistem të mbyllur	25	12.03	300.75	
		Maska faciale me rezervuar dhe valvule njëkahëshe	100	2.31	231.48	

		Maska faciale me gotë për inhalim	100	3.24	324.07	
		Katetera venoz qëndror 7 Fr	50	15.74	787.04	
5	BULI Medical	Aparatura hematologjike	2	8,000.00	16,000.00	Klinika e Biokimisë
6	Office of Defense Cooperation - US Embassy	Acid base balance Analyzer	2	17919.58	35839.16	SHSKUK
		Oxygen pressure Regulator with flowmeter	100	31.36	3135.84	
		Wall/directly mounted Oxygen-flowmeters	100	41.5	4149.58	
		Double wall/directly oxygen floëmers	100	71.06	7106.33	
		NIV Masks (CPAP)	100	27.98	2797.93	
7	Office of Defense Cooperation - US Embassy	Patient Monitor	15		165,018.00	QKUK
		Central Monitor Station	1	13,065.00	13,065.00	
		Ultrasound device	1	71,500.00	71,500.00	
		Emergency&Trauma patient trolleys	10		29,445.00	
8	Aksioni për Nëna dhe Fëmijë - AMC	Oxygen pressure Regulator with flowmeter	25	80.00	2,000.00	QKUK
		Wall/directly mounted Oxygen-floëmers	20	50.00	1,000.00	
		Double wall/directly oxygen flowmeters	20	98.00	1,960.00	
9	Embassy of the United States of America	Heated inspiratory circuit	500	32.77	16,387.79	QKUK
		Oxygen pressure regulator for cylinders - MT-Ë	100	107.82	10,782.74	
		Oxygen pressure regulator for cylinders - MT-W 21.8	50	107.82	5,391.37	
		Oxygen pressure regulator ëall connected XF-C/DIN	100	84.87	8,487.04	
		Oxygen wall directly mounted flowmeter LYX-AC18	200	54.84	10,969.93	
		Oxygen pressure Regulator with flowmeter YR-87-1	200	72.5	14,501.78	
		Electrocardiographs CM 1200A with accessories, 12	30	1246.74	37,402.31	
		Electrosurgical generator with accessories	20	7250.89	145,017.84	
		Disposable adult breathing circuities, ped/adults	1,000	75.14	75,157.81	
		Disposable infant breathing circuits	20	187.89	3,757.89	

		Oxygen sensorfor TV-100 ventilator	10	319.72	3,197.21	
		Oxygen sensor for Crossvent3	10	231.44	2,314.42	
		Disposable adult breathing circuits VentStarOxylog	1,000	46.02	46,020.03	
		Disposable pediatric breath. circuits	300	46.02	13,806.01	
10	Community Development Fund – CDF	Medical/surgical mask/ three layers	1,180	0.10	118.00	SHSKUK
		Respirator (FFP2/N95)	7,100	2.18	15,478.00	
		Gloves, examination (piece, not pair)	185	0.08	14.80	
		Alcohol-based hand rub, bottle 1000ml	730	3.40	2,482.00	
		Multiuse masks (textile)	0	0.00	0.00	
		Shoe covers Package (pack of 100 pieces)	310	1.90	589.00	
		Disposable protective cover all with elastic cuffs, attached hood and boots	2,150	4.15	8,922.50	
		Disposable protective cover all with elastic cuffs and hood light	2,150	3.20	6,880.00	
11	Avex	Favipiravir 200mg tab	52,020	1.50	78,030.00	Klinika / Reparti
12	Aksioni per Nëna dhe Fëmijë	Doreza PVC latex M	5,000	0.08	390.00	Klinika Obstetrike Gjinekologj.
		Doreza PVC latex L	1,000	0.08	78.00	
		Maska surgical	2,400	0.06	153.60	
		Alkool 70% 1L	99	1.85	183.15	
		Dizinfktues per duar 500ml sol	100	1.95	195.00	
13	Pharma Leader	Ciprofloxacin 200mg/100ml sol	1,000	2.88	2,880.00	Njësiti Covid
14	Exclusive Cooperation	Ciprofloxacin 200mg/100ml sol	1,000	3.60	3,600.00	Njësiti Covid
15	Santefarm	Ciprofloxacin 100mg/10ml sol	1,000	0.96	961.00	Njësiti Covid
16	Meditech	Gjilpera per insulin 30G	400	0.15	58.00	Klinika / Reparti
		Ciprofloxacin 100mg/10ml sol	1,350	0.68	919.15	Njësiti

						Covid
17	Madekos	Cover shoes	4,000	0.01	40.00	Njësitë Covid
18	Madekos	Shoe cover	4,000	0.04	160.00	Klinika / Reparti
19	Madekos	Shoe cover	8,000	0.04	320.00	Klinika / Reparti
20	Buçaj	Favipiravir 200mg tab	1500	0.50	750.00	Klinika / Reparti
					GJITHSEJ	3,082,938.17

Vlera e përgjithshme e donacioneve, e shprehur në shifra financiare të pranuar në ShSKUK për vitin 2021 është rreth 15 milion euro (14.710.702.⁹¹ Euro), prej të cilave mbi 3 milion euro (3.082.938.¹⁷ Euro) janë të dedikuara për trajtimin e pacientëve COVID-19. Këto donacione përfshijnë ventilatorë (respiratorë), monitorë, pulsoksimetra, aparate të ultrazërit, fluometra, aparate laboratorike për analiza hematologjike, biokimike, pajisje mbrojtëse personale (PPE) si: maska faciale, dorëza, etj., por edhe barëna për trajtimin e pacientëve COVID-19, si favipiravir, ciprofloxacina etj. (shih tabelën e mësipërme).

4. Furnizimi me barëna dhe material shpenzues mjekësor

Shkurtimi i buxhetit për barëna (rmallra dhe shërbime) për vitin 2021, vështirësitë në procedurat e lidhjes së kontratave, vështirësitë e krijuara në tregun farmaceutik si pasojë e gjendjes emergjente globale shëndetësore, kanë afektuar furnizimin me barëna dhe material shpenzues mjekësorë. Edhe përkundër kësaj, furnizimi me barëna dhe material shpenzues për trajtimin e pacientëve të sëmurë me COVID-19 ka vazhduar në mënyrë të rregullt, duke iu dhënë prioritet furnizimit me oksigjen dhe me barëna kryesore sipas UPK për COVID-19. Furnizimi është stabilizuar në mënyrë të ndjeshme gjatë gjysmës së dytë të vitit 2021, pas alokimit të 8 milion euro shtesë me rishikimin e buxhetit. Përveq kësaj, Qeveria e Republikës së Kosovës në fund të vitit 2021 e mbështetë ShSKUK duke i ndarë mjete financiare shtesë edhe 2 herë, në vlerë 3.2 respektivisht 2.5 milion euro.

Referuar udhëzuesit të protokolit klinik (UPK) për trajtimin e pacientëve me COVID-19 gjatë vitit 2021 është arritur të stabilizohet furnizimi pothuajse me të gjitha barënat e parapara në këtë protokol, me përjashtim të Remdesivirit i cili nuk arrihet të sigurohet deri kah fundi i vitit 2021. Arësyeja e mungesës së Remdesivirit gjatë vitit 2021 është se MSh kishte filluar më herët procedurat për blerjen e këtij bari, por nuk kishte arritur të lidhë kontratë.

Favipirafir ka qenë në dispozicion në sasi të mjaftueshme i siguruar nga donacionet. Me Tocilizumab jemi furnizuar nga kontrata e ShSKUK-së dhe kemi arritur të kontraktojmë sasi shtesë gjatë vitit 2021, por që nuk kanë qenë të mjaftueshme përgjatë tërë vitit. Në gjysmën e dytë të vitit MSh përmes marrëvshjeve me UNOPS-in inicion procedurat për furnizim me disa nga barënat kryesore për trajtimin e pacientëve të sëmurë me COVID-19, në mesin e të cilave Remdesivir dhe Tocilizumab, por që deri në përfundimin e valës së muajit Gusht-Shtator MSh

muk ka arritur të furnizojë me Remdesivir dhe Tocilizumab ShSKUK-në. Në disa periudha të caktuara kohore është hasur në vështirësi për sigurimin e Ciprofloxacines dhe Heparinës për shkak të procedurave të ankesave në OSHP. Mungesa e ciprofloxacines është zëvendësuar me antibiotikë tjerë sipas nevojës, ndërsa për heparinë ShSKUK është detyruar të zhvillojë procedura tjera alternative.

Procedurat e prokurimit, në të shumtën e rasteve paraqesin sfidën kryesore në sigurimin me kohë dhe të qëndrueshëm të barëname dhe materialit medicinal shpenzues, pasi Kosova nuk ka ligj të veçantë të prokurimit për produktet medicinale. Duhet përmendur faktin se nga data 04. Shkurt 2021 ka filluar edhe përdorimi i plazmës konvaleshente për trajtimin e pacientëve të prekur nga COVID-19, e cila ka shënuar një progres tjetër dhe ka rritë cilësinë e menaxhimit klinik të pacientëve të sëmurë nga COVID-19.

Në tabelën 4.1. paraqitet në detaje situata e furnizimit (e vlerësuar në muajin Shkurt 2021) për secilin ilaç veç e veç të paraparë në udhëzuesin e protokolit klinik për trajtimin e pacientëve me COVID-19.

Tabela 4.1. Gjendja me furnizim (në muajin Shkurt 2021) me barëna sipas udhërrëfyesit të protokolit klinik për trajtimin e të sëmurëve me COVID-19

	Emri Gjenerik	Doza & Vëllimi	Validiteti i kontratave	Furnizimi
1	Paracetamol	Tableta: 500 mg.	Nuk ka kontratë, nuk ka ofertues për këtë artikull.	Për shkak të vlerave të vogla, nuk ka ofertues. Furnizimi është bërë kohë pas kohë me kontrata emergjente (furnizim deri në 1,000 Euro). Për momentin ka stoqe të mjaftueshme. Poashtu, ka furnizim stabil me Paracetamol injeksion (shih në vijim).
2	Paracetamol	Injeksion: 1g	26.05.2020 26.05.2022	Furnizimi është i qëndrueshëm
3	Acid Ascorbic (Vitamin C)	Tableta: 500 mg	Nuk ka kontratë, nuk ka ofertues	Furnizimi është i qëndrueshëm me kontratë emergjente (furnizim deri 1,000 Euro). Për shkak të vlerave të vogla, nuk ka ofertues. Mirëpo, ka furnizim të qëndrueshëm me Vitamin C injeksion (shih në vijim).
4	Acid ascorbic (Vitamin C)	Injeksion: 500 mg/5 ml,	04.08.2020 04.08.2022	Ka kontratë valide, në fillim ka pasë vonesa në liferim nga ana e OE.
5	Vitamin D3	Forma orale 1000-4000IU	04.12.2020 04.05.2021	Ka kontratë valide, furnizimi është i qëndrueshëm.
6	Vitamin D3	Injeksion: 1000-4000IU	04.12.2020 04.05.2021	Ka kontratë valide, furnizimi është i qëndrueshëm.

7	Vitamin B-Complex	Tabletë	Nuk ka kontratë, nuk ka ofertues	Furnizimi ka munguar për shkak se nuk ka ofertues për këtë ilaç. Megjithatë, ka furnizim të mjaftueshëm me Vit. B-complex injeksion (shih në vijim).
8	Vitamin B-Complex	Injeksion	03.12.2020 02.06.2021	Furnizimi është i qëndrueshëm
9	Azithromycin	Kapsula: 500 mg	04.12.2020 04.05.2021	Furnizimi është i qëndrueshëm
10	Azithromycin	Tretësire orale: 200 mg/5 mL.	14.05.2020 14.05.2022	Furnizimi është i qëndrueshëm
11	Enoxaparin	40 mg/0.4 mL Injeksion: amp. apo shiringë e para-mbushur	02.10.2020 02.10.2022	Kërkesat për furnizim me enoxaparinë kanë qenë të mëdha dhe kanë tejkaluar çdo parashikim dhe planifikim të njësive kërkuese. Momentalisht furnizimi është i qëndrueshëm.
12	Enoxaparin	60 mg/0.6 mL Injeksion:amp. apo shiringë e para-mbushur	09.12.2020 09.05.2021	Kërkesat për furnizim me enoxaparinë kanë qenë të mëdha dhe kanë tejkaluar çdo parashikim dhe planifikim të njësive kërkuese. Kemi furnizim. Poashtu janë rinicuar procedurat për furnizim
13	heparin natrium	Injeksion: 5000 IU/ mL; në amp.1 mL.	28.12.2020 28.03.2021	Lënda për furnizim me Heparin –procedura e rregullt është duke u trajtuar në OSHP. Furnizimin jemi duke e realizuar përmes kontratës emergjente
14	Hydroxyl-Chlorochine	Tableta: 200 mg	Nuk ka kontratë	Është siguruar donacion nga MSH. Ka furnizim të mjaftueshëm.
15	dexamethasone	Injeksion: 4 mg/mL në ampulla 1 mL	08.10.2020 08.10.2022	Furnizimi është i qëndrueshëm
16	Methyl-Prednisolone	Injeksion: 40 mg/ mL (si sukcinat natriumi)	22.05.2020 22.05.2022	Furnizimi është i qëndrueshëm
17	Favipiravir	Tableta: 200mg		Jemi furnizuar donacion nga MSh dhe operatorët ekonomik.
18	Remdesivir	Injeksion: 100mg	Produkti ka qenë në prokurim në MSh.	Nuk jemi frunizuar me këtë ilaç, MSH nuk ka arritur të lidhë kontratë.

19	Tocilizumab	Shiringë e parambushur: 200 mg/10 ml;	Kontrata valide është për dozën 80mg/4ml. 08.04.2020 08.04.2022	Furnizimi ka qenë i qëndrueshëm. Për shkak të kërkesave të larta (shpenzueshmërisë së lartë), herë pas here janë paraqitur mungesa. Për dozën 200mg/10 ml MSh nuk ka arritë të lidhë kontratë.
20	Ciprofloxacin	200mg/100ml; sol. për infusion	Nuk ka kontratë për furnizim, lënda është në OSHP	Nuk ka furnizim.
21	Imipenem + Cilastatin	500mg+ 500mg; amp	09.12.2020 09.05.2021	Edhe përkundër shpenzimeve të larta, përtej parashikimeve dhe planifikimeve të njësive kërkuese, është arritur të sigurohet furnizim i qëndrueshëm.
22	Meropenem	500mg	01.09.2020 01.09.2022	Kërkesat për meropenem kanë qenë të mëdha duke tejkaluar çdo parashikim dhe planifikim të njësive kërkuese. Furnizimi është i qëndrueshëm.
23	Vancomycin	500mg; amp	03.12.2020 03.05.2021	Furnizimi është i qëndrueshëm.
24	Ceftriaxone	1g pluhur për solucion për injeksion	02.09.2020 02.09.2022	Furnizimi është i qëndrueshëm.
25	Piperacilin/ Tazobactam	4.0+0.5 g pluhur për infusion	01.09.2020 01.09.2022	Furnizimi është i qëndrueshëm.
26	Ethanol	Tretësirë: 70% (i denaturuar).	22.07.2020 22.07.2022	Furnizimi është i qëndrueshëm.
27	Maska me balon		04.12.2020 03.12.2021	Furnizimi është i qëndrueshëm.

5. Furnizimi me pajisje mbrojtëse personale (PPE) për stafin shëndetësorë dhe teknik-mbështetës

Furnizimi me material mbrojtës për personelin shëndetësorë dhe jo-shëndetësorë gjatë gjithë vitit ka qenë stabil dhe i mjaftueshëm. Nuk është paraqitur asnjëherë asnjë mungesë për PPE. Në analizën dhe vlerësimin e bërë në fillim të vitit 2021, stoqet në dispozicion janë vlerësuar të mjaftueshme. Duhet theksuar se një pjesë e konsiderueshme e materialit PPE është siguruar përmes donacioneve nga partnerët ndërkombëtarë.

Tabela nr. 5.1. pasqyron gjendjen e furnizimit me PPE (vlerësuar në muajin Shkurt 2021).

	Emri i produktit	Validiteti i kontratave	Furnizimi
1	FFP2 respiratory masks, with valve, extra light, latex and PVC free.	Nuk ka kontratë	Ka stoqe të mjaftueshme.
2	Disposable protective coverall with elastic cuffs, attached hood	Nuk ka kontratë	Ka stoqe të mjaftueshme.

	and boots, white; Clothing size L;		
3	Disposable Protective Coverall with elastic cuffs , attached Hood and Boots White . Clothing sizes XL.	Nuk ka kontratë	Ka stoqe të mjaftueshme.
4	Disposable Protective Coverall with elastic cuffs , attached Hood and Boots White. Clothing sizes XXL.	Nuk ka kontratë	Ka stoqe të mjaftueshme.
5	Face shield , full length Visor , Fog resistant face shield , Foam Band and Headband	Nuk ka kontratë	Ka stoqe të mjaftueshme.
6	Google protective	Nuk ka kontratë	Ka stoqe të mjaftueshme.



Foto 3. Pajisje mbrojtëse personale (PPE) të mjaftueshme për personelin shëndetësorë



Foto 4. Pajisje mbrojtëse personale (PPE) adekuate për personelin shëndetësorë

6. Furnizimi me dezinfektues dhe dezinfektimi i rregullt i ambienteve / hapësirave spitalore në Klinikat /Repartet COVID-19

Dezinfektimi i rregullt i ambienteve / hapësirave spitalore në repartet/klinikat ku trajtohen pacientët me COVID-19 është shumë i rëndësishëm për sigurimin e një ambienti të sigurt të punës në kuptim të zvogëlimit të mundësisë së përhapjes së infeksionit COVID-19 në mesin e personelit shëndetësorë. Qysh para fillimit të pandemisë institucionet shëndetësore, nën mbështetjen e IKSHPK dhe Agjensionit të Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) kanë përgatitur rekomandimet për nevojën e dezinfektimit të rregullt të ambienteve/hapësirave ku do të trajtohen pacientët me COVID-19. Në zbatim të këtyre rekomandimeve, ShSKUK me kohë ka planifikuar këtë aktivitet dhe ka siguruar materialet e nevojshme (dezinfektuesit) për dezinfektim të rregullt, ndërsa sfida kryesore në këtë aktivitet ka qenë mungesa e stafit të dedikuar vetëm për këtë qëllim. Në mungesë të këtij stafi, ShSKUK ka bërë zgjedhje alternative duke trajnuar stafin e mirëmbajtjes së higjienës për këtë qëllim.

Tabela 6.1 paraqet situatën e furnizimit me materiale dezinfektuese, si dhe me dorëza dhe materiale tjera të vlerësuar në Shkurt 2021.

Tab. 6.1. Gjendja e furnizimit me materiale dezinfektuese dhe dorëza (vlerësuar në Shkurt 2021)

	Emri i produktit		Validiteti i kontratave	Furnizimi
1	Dezinfektues për duar		14.05.2020 13.05.2022	Furnizimi është i qëndrueshëm.
2	Dezinfektues për dysheme		14.05.2020 13.05.2022	Furnizimi është i qëndrueshëm.
3	Shampon për duar		14.05.2020 13.05.2022	Furnizimi është i qëndrueshëm.
4	Mask Surgical Disposable		05.02.2021 04.08.2021	Furnizimi është i qëndrueshëm.
5	Gloves Examination	Large	05.02.2021 04.08.2021	Furnizimi është i qëndrueshëm.
6	Gloves Examination	Medium	05.02.2021 04.08.2021	Furnizimi është i qëndrueshëm.
7	Gown Surgical Sterile Disposable	Large	05.02.2021 04.08.2021	Furnizimi është i qëndrueshëm.
8	Gown Surgical Sterile Disposable	Medium	05.02.2021 04.08.2021	Furnizimi është i qëndrueshëm.



Foto 5. Material dezinfektues dhe pajisje mbrojtëse për personelin shëndetësorë



Foto 6. Materiali dezinfektues



Foto 7. Dezinfektues për duar

PANDEMIA COVID-19 GJATË VITIT 2021 NË KOSOVË

ShSKUK kursen miliona Euro pas vendosjes së Cryo-tankeve - rezervoarëve të oksigjenit të lëngshëm

ShSKUK e fillon vitin 2021 me përgatitje shumë më të mira se vitin paraprak, në mënyrë të veçantë me zgjidhjen e çështjes së furnizimit me oksigjen. Instalimi i rezervoarëve të oksigjenit në Spitalet e Përgjithshme ka stabilizuar furnizimin me oksigjen duke siguruar furnizim të qëndrueshëm dhe duke zgjidhur kështu sfidën emergjente me të cilën ShSKUK u ballafaqua në vitin e parë të pandemisë COVID-19. Përveq kësaj, stabilizimi i furnizimit me oksigjen rritë kualitetin e shërbimeve, rritë sigurinë e stafit shëndetësorë por edhe sigurinë dhe besimin e pacientëve.

Kosova gjatë vitit 2021 u ballafaqua me 2 valë të pandemisë COVID-19. Njëra valë shpërtheu gjatë muajve Mars – Prill, ndërsa vala tjetër gjatë muajve Gusht - Shtator. Në valën e muajve Mars – Prill shkalla e infektiozitetit ishte e lartë në popullatë, por me një shpërthim më të ngadalshëm se vala e ardhshme e muajve Gusht-Shtator. Numri maksimal i të spitalizuarve gjatë muajve Mars – Prill 2021 arriti pikun në fund të Marsit me 965 pacientë të spitalizuar. Vala e muajve Gusht – Shtator 2021 ishte vala më e ashpër e COVID-19, ku shkalla e infektiozitetit ishte tejet e lartë në popullatë dhe me një përhapje shumë të shpejtë.

Para fillimit të pandemisë COVID-19 furnizimi me oksigjen medicinal në të gjitha Spitalet e Përgjithshme të Kosovës është bërë 100% përmes cilindrave (bombolave) me oksigjen të gazët, (shih fotot më poshtë) ndërsa rezervuarë (cryo-tanke) për furnizim me oksigjen të lëngshëm ka pasur vetëm në QKUK (3 cryo-tanke me një kapacitet gjithsej prej 20 ton). Ndërkohë që numri i shtretërve të kyçur në sistemin e oksigjenit qendror nëpër Spitalet e Përgjithshme dhe Klinikat e QKUK ka qenë fare simbolik.



Foto 8 & 9. Furnizimi me oksigjen të gazët përmes bombolave



Foto 10 & 11. Bombolat e oksigjenit pranë shtratit të pacientëve

ShSKUK ka arritur që në kohë rekorde të zhvilloj planin për ndryshimin e sistemit të furnizimit të Spitaleve me oksigjen medicinal, duke kaluar nga furnizimet me bombola në furnizim me oksigjen të lëngët. Vendimi për ndryshimin e sistemit të furnizimit me oksigjen i marrë nga ShSKUK është ***vendimi më i rëndësishëm strategjik dhe jetik për menaxhimin e pandemisë COVID-19***. Tani ShSKUK ka instaluar rezervoarët për furnizim me oksigjen të lëngët në të gjitha Spitalet e Përgjithshme, ndërkohë ka rritur kapacitetet edhe në QKUK. Për dallim nga viti 2020 kur ShSKUK kishte në përdorim cryo-tanke për oksigjen të lëngët vetëm në QKUK me një kapacitet gjithsej prej 20 ton, në vitin 2021 ky kapacitet në nivel të ShSKUK-së është rritur gjithsej në 95 Ton. (tabela e mëposhtme).

Tabela 7. Shtimi i kapaciteteve fizike me rezervoar (cryo-tanke) për Oksigjen të lëngët (shprehur në ton)

OKSIGJEN	NJËSIA	QKUK	PRIZREN	GJILAN	GJAKOVË	PEJË	VUSHTRI	FERIZAJ	MITROVICË	GJITHSEJ
PARA PANDEMISË	3 Cryo-Tanke (10+5+5ton)	20	0	0	0	0	0	0	0	20 Ton
GJATË PANDEMISË	3 Cryo-Tanke (20+10+5ton)	40	10	10	10	10	5	5	5	95 Ton





Cryo-tanku 10 ton, SP Prizren



Cryo-tanku 10 ton, SP Gjilan



Cryo-tanku 10 ton, SP Pejë



Cryo-Tanku 10 ton, SP Gjakovë




Cryo-tanku 20 T, prapa Kl.Infektive -QKUK



Cryo-tanku 20 T, prapa Kl.Infektive -QKUK



Cryo-tanku 10 Ton, Kl.e Pulmologjisë



Oksigjeni qendror – monitorim digjital

Krahas instalimit të cryo-tankeve për oksigjen të lëngët në të gjitha Spitalet e Kosovës, ShSKUK paralelisht ka zhvilluar edhe planin për zgjerimin e rrjetit të oskigjenit qendror në QKUK dhe Spitalet e Përgjithshme (për të rritur numrin e shtretërve që janë të kyçur në sistemin qendror të oksigjenit). Është arritur që të instalohet ky sistem qendror në Klinikën Infektive, në Klinikën e Pulmologjisë dhe në Klinikat Internistike të QKUK-së, ndërkohë që është përforcuar sistemi qendror edhe në njësinë e kujdesit intenziv. Shtimi i shtretërve të kyçur në sistemin qendror në të gjitha Spitalet e Përgjithshme është planifikuar të financohet nga MSh përmes kredive të buta dhe të realizohet përmes UNOPS, por gjatë vitit 2021 ky aktivitet nuk është arritur të realizohet.

Megjithatë, me rritjen e numrit të shtretërve të kyçur në sistemin qendror të oksigjenit në klinikat e QKUK-së është arritur të sigurohet numër i konsiderueshëm i shtretërve të kyçur në sistemin qendror. Kështu, përderisa në fillim të pandemisë në QKUK kishim më pak se 150 shtretër të kyçur në sistemin qendror të oskigjenit, gjatë vitit 2021 kemi arritur të shtojmë numrin e shtretërve të kyçur në këtë sistem në mbi 450, pra është rritur prej rreth 300 shtretër më shumë vetëm në QKUK.


Me këto 2 projekte:

1. Vendosjen e cryo-tankeve në Spitalet e Përgjithshme & QKUK, dhe;
2. Zgjerimin e rrjetit të sistemit qendror të oksigjenit në klinikat e QKUK-së;

është arritur të stabilizohet furnizimi me oksigjen i QKUK-së dhe SP, edhe është zgjidhur përfundimisht problemi kryesor i furnizimit të qëndrueshëm me Oksigjen qendror në Spitalet e Përgjithshme dhe Qendrën Klinike Universitare të Kosovës për një periudhë të gjatë kohore.

Përparësitë e furnizimit me oskigjen në formë të lëngët krahasur me oskigjenin e gazët:

- është shumë lehtë më i qasshëm në treg;
- është shumë më i sigurt – pasi bombolat tek shtrati i pacientëve paraqesin rrezik për shëndetin e pacientëve por edhe të stafit shëndetësorë;
- krijon siguri dhe rritë vetbesimin tek punëtorët shëndetësorë;
- rritë sigurinë edhe tek pacientët, e poashtu edhe besimin e tyre ndaj stafit shëndetësorë;
- nuk ndodhin dëmtimet e dysHEMEVE të klinikave (siq ndodhë gjatë bartjes së bombolave nëpër koridoret dhe dhomat e pacientëve);
- nuk kërkon fuqi punëtore (numër të madh të stafit të anagzhuar siq nevojitet për bartjen e bombolave nëpër secilën dhomë të pacientëve)
- është për 8-10 herë më i lirë se sa oksigjeni i gazët në bombola.



Oksigjeni – me bombola
(para instalimit të oskigjenit qendror)



Sistemi i oksigjenimit qendror



Vala e Pandemisë COVID-19 gjatë muajit Mars-Prill 2021

Përgjatë 2 muajve të parë të vitit 2021 (Janar-Shkurt 2021) ka mbizotëruar një situatë relativisht e qetë dhe lehtë e menaxhueshme për sa i përket numrit të pacientëve të spitalizuar nga COVID-19 dhe trajtimit të tyre spitalor. Numri i pacientëve të spitalizuar gjatë kësaj periudhe në nivel të ShSKUK-së sillej në rreth 500 (nga 460-520 piku më i lartë).


Gjatë këtyre 2 muajve, të gjitha SP kanë pacientë të spitalizuar me COVID-19, ndërsa në QKUK pacientët e sëmurë nga COVID-19 janë trajtuar në Klinikën Infektive, Klinikën e Sëmundjeve të Mshkërive, në Objektin e Ndërtesës së Mjekësisë Sportive, në Mjekimin Intenziv Qendror (për pacientët në gjendje të rëndë), një repart në Klinikën e Pediatriisë për fëmijët me COVID-19, dhe një repart në Klinikën Obstetrike-Gjinekologjike për gratë shtatzëna të infektuara me COVID-19.

Java e parë e Muajit Mars 2021 shënon fillimin e rritjes së numrit të të spitalizuarve me COVID-19 duke shënuar fillimin e valës së tretë të Pandemisë COVID-19 në Kosovë. Kështu, numri i të spitalizuarve nga COVID-19 në javën e parë të Marsit 2021 arrin në rreth 600, prej të cilëve 2/3 e tyre (400 pacientë janë në oksigjenoterapi të vazhdueshme), ndërsa 30 pacientë në gjendje të rëndë shëndetësore trajtohen në repartet e kujdesit intenziv. Numri më i lartë i pacientëve të spitalizuar gjatë kësaj vale shënohet në fund të muajit Mars kur piku arrihet me 965 pacientë të spitalizuar.

Duhet potencuar faktin se edhe përkundër numrit të lartë të pacientëve me COVID-19 që kërkuan trajtim spitalor gjatë muajit Mars dhe Prill 2021, ShSKUK nuk ka kufizuar gjatë kësaj vale të pandemisë asnjë shërbim shëndetësor, duke operuar me kapacitete të plota të gjitha shërbimet, përfshirë shërbimet në ambulancat specialistike si dhe intervenimet kirurgjike elektive.

Muajt Maj, Qershor dhe Korrik 2021 karakterizohen me situatë të qetë epidemiologjike e cila reflekton në uljen e numrit të të spitalizuarve me COVID-19 në nivel të ShSKUK-së. Kështu përgjatë këtyre muajve në nivel të ShSKUK trajtim spitalor kërkojnë 647 pacientë gjatë muajit Maj, 202 pacientë gjatë muajit Qershor dhe 146 pacientë gjatë muajit Korrik 2021.

Grafikoni 1. Nr.i pacientëve COVID-19 të spitalizaur në Klinikat e QKUK Mars-Prill 2021



Gjatë valës së muajit Mars-Prill 2021 në klinikat e QKUK janë trajtuar gjithsej 1,776 pacientë me COVID-19, (933 gjatë muajit Mars dhe 843 gjatë muajit Prill). Sipas klinikave, 547 pacientë janë trajtuar në Klinikën Infektive, 461 në Objektin e Mjekësisë Sportive, 283 në Klinikën e Sëmundjeve të Mushkërive* dhe 258 pacientë në Bllokun e Klinikave Internistike. Gjatë kësaj vale numri i fëmijëve të infektuar me COVID-19 që kanë kërkuar trajtim spitalor është 33, ndërsa numri i grave shtatzëna me COVID-19 të spitalizuaara gjatë kësaj periudhe është 48. Në Mjekimin Intesiv Qendror të QKUK gjatë valës Mars-Prill 2021 u trajtuan gjithsej 142 pacientë.

Tabela 8. Numri i Pacientëve COVID-19 të trajtuar në QKUK gjatë valës Mars-Prill 2021

		Mars 2021	Prill 2021	Gjithsej
1	Klinika Infektive	303	244	547
2	Objekti i QKMS (Mjekësia Sportive)	274	191	461
3	Klinika e Sëmundjve të Mushkërive	172	111	283
4	Klinikat Internistike	64	194	258
5	MIQ	72	70	142
6	Klinika Obstetrike-Gjinekologjike	32	16	48
7	Klinika Pediatrike	16	17	33
	Gjithsej QKUK	933	843	1,776

Në Spitalet e Përgjithshme gjatë valës Mars-Prill 2021 trajtim spitalor kërkuan gjithsej 2,772 pacientë të infektuar me COVID-19.

Grafikoni nr. 2 paraqet numrin e pacientëve të spitalizuar sipas Spitaleve të Përgjithshme gjatë muajit Mars dhe Prill 2021.

Grafikoni 2. Nr.i pacientëve COVID-19 të spitalizaur në SP, Mars-Prill 2021




Tabela 9. Numri i Pacientëve COVID-19 të trajtuar në SP gjatë valës Mars-Prill 2021

SPITALI I PËRGJITHSHËM	Mars 2021	Prill 2021	Gjithsej
SP i Prizrenit	345	308	653
SP i Gjiçanit	355	228	583
Sp i Pejës	214	227	441
Sp i Gjakovës	189	170	359
Sp i Ferizajit	168	154	322
Sp i Mitrovicës	125	153	278
SP i Vushtrisë	82	54	136
Gjithsej Spitalet e Përgjithshme	1,478	1,294	2,772

Vala e Pandemisë COVID-19 gjatë muajve Gusht - Shtator 2021

Pas një periudhe 3-mujore të qetë epidemiologjike (Maj, Qershor, Korrik), Kosova përballet me valën e radhës të pandemisë COVID-19 gjatë muajve Gusht-Shtator 2021. Kjo valë ishte vala më e ashpër që nga fillimi i Pandemisë në Kosovë, duke arritur numrin më të lartë të të spitalizuarve – pikun me rreth 1,300 të spitalizuar në fund të muajit Gusht 2021. ShSKUK për këtë valë kishte përgatitur planin e veprimit për ridestitim deri në 1,750 shtretër për COVID-19 në skenarin më të ashpër (Faza e III-të e planit të veprimit).

Kjo valë karakterizohet me disa karakteristika që e dallojnë nga valët e kaluara:

1. Shkallë e lartë e përhapjes së koronavirusit në popullatë e shoqëruar me numër të lartë të të infektuarve;
2. Përhapje shumë më e shpejtë dhe më e lehtë e virusit në popullatë;
3. Shkalla e lartë e infeksionit pasohet me numër të madh të të infektuarve në periudhë të shkurtër kohore;
4. Numër i madh i të spitalizuarve në periudhë të shkurtër kohore, e cila sjell mbingarkesë enorme të SP dhe QKUK;
5. Disa ditë me radhë kërkesat për spitalizim gjatë gjysmës së dytë të muajit Gusht 2021 ishin deri në 100 pacientë breneda 24 orëve, duke bërë kështu që shumë shpejtë të arrihet piku i të spitalizuarve me rreth 1,300 pacientë në fund të muajit Gusht (1,284 pacientë me COVID-19 ishin të spitalizuar në nivel të ShKSUK-së me 31. Gusht 2021).

Edhe përkundër kësaj, ShSKUK arriti me sukses që të përballojë edhe këtë valë, duke siguruar shtretër për të gjithë pacientët që kërkonin spitalizim, riroganizim dhe angazhim pothuajse të të gjithë personelit shëndetësorë dhe jo-shëndetësorë në trajtimin e pacientëve me COVID-19, sigurimin e shumicës së barnave dhe materialit shpenzues mjekësorë, sigurimin e mjaftueshëm të paisjeve mbrojtëse personale (PPE) për të gjithë stafin shëndetësorë dhe jo-shëndetësorë. Asnjë pacient që kishte nevojë për spitalizim nuk ka mbetur pa u spitalizuar dhe ShSKUK anjë ditë të vetme nuk ka mbetur pa shtretër të mjaftueshëm për pacientët që kishin nevojë për trajtim spitalor. Furnizimi me oksigjen tashmë ishte zgjidhur, dhe në këtë valë - çështja e furnizimit me oksigjen nuk ishte temë.

Për shkak të nevojës për të siguruar, përkatësisht ridestinuuar shtretër të mjaftueshëm për pacientët me COVID-19 si dhe personel të mjaftueshëm për trajtimin e pacientëve me COVID-19, ShSKUK u detyrua që për një periudhë kohore prej rreth 3-4 javësh (nga java e fundit e Gushtit deri në javën e tretë-katërt të Shtatorit të pezullojë shërbimet në ambulancat specialistike si dhe intervenimet kirurgjike elektive. ShSKUK kishte rikthyer të gjitha shërbimet duke punuar me kapacitete të plota nga data 5 Janar 2021, dhe kjo periudhe 3-4 javore (gjatë muajit Shtator) është periudha e vetme gjatë tërë vitit 2021 kur u pezulluan vizitat specialitike dhe operacionet kirurgjike elektive.

Gjatë gjysmës së dytë të muajit Shtator fillon të ulet numri i pacientëve të spitalizuar me COVID-19, për të kaluar tremujorin e fundit të vitit 2021 (Tetor-Dhjetor 2021) në një situatë të qetë epidemiologjike me numër të vogël të pacientëve që kërkojnë spitalizim.

Sa i përket planifikimeve për sigurimin e shtretërve të mjaftueshëm për nevojat e pacientëve me COVID-19 që mund të kërkonin trajtim spitalor, ShSKUK për këtë valë ka përgatitur planin e veprimit për të ridestinuuar deri në 1,750 shtretër në nivel të ShSKUK-së. Ky plan është i ndarë në 3 faza, varësiht nga skenarët e mundshëm:

Faza e I-rë: sigurimi deri në rreth 800 shtretër për spitalizimin e pacientëve me COVID-19;

Faza e II-të: sigurimi deri në 1,300 shtretër për pacientët me COVID-19;

Faza e III-të; zgjerimi i hapësirave - ridestinimi deri në 1,750 shtretër për nevojat e pacientëve me COVID-19.

Plani i veprimit për shtimin e numrit të shtretërve për trajtim të pacientëve COVID-19 në valën e muajit Gusht-Shtator 2021:

Shtimi i shtretërve në njësitë përbërëse të SHSKUK është bërë i kohë paskohshëm, bazuar në situatën epidemiologjike dhe nevojën për trajtim spitalor, andaj janë krijuar planet rreth menaxhimit të shtretërve sipas kërkesës për trajtim në tre (3) faza:

Kapacitetet Spitalore me shtretër në ShSKUK, Faza -I-

Nr	Njësia	Nr. i Shtretërve	Oksigjen Qendror	Bombola
1	QKUK	224	198	26
2	Spitalet e Përgjithshme	555	387	168
	Gjithsej	779	585	194

Faza I: në QKUK për fazën e parë si klinika COVID shërbejnë Klinika Infektive (126 shtretër, dhe Klinika e Pulmologjisë me Dermatovenerologji 98 shtretër).

Spitalet e Përgjithshme kanë vënë në dispozicion gjithsej 555 shtretër, prej të cilëve 387 shtretër kanë qasje në sistemin qendror të oksigjenit.

Kapacitetet Spitalore me shtretër në ShSKUK, Faza -II-

Nr	Njësia	Nr. i Shtretërve	Oksigjen Qendror	Bombola
1	QKUK	434	408	26
2	Spitalet e Përgjithshme	876	479	397
	Gjithsej	1,310	887	423

Faza II: në QKUK për fazën e dytë klinikave COVID nga faza I i shtohen edhe Objekti i Mjekësisë Sportive (me 98 shtretër) dhe Klinikat e Bllokut Internistik (112 shtretër)

Spitalet e Përgjithshme për fazë e dytë vënë në dispozicion gjithsej 876 shtretër, prej të cilëve 479 me qasje në sistemin qendror të oksigjenit. Gjithsej për këtë fazë planifikohen deri në 1,300 shtretër.

Kapacitetet Spitalore me shtretër në ShSKUK, Faza -III-

Nr	Njësia	Nr. i Shtretërve	Oksigjen Qendror	Bombola
1	QKUK	625	409	216
2	Spitalet e Përgjithshme	1,125	511	614
	Gjithsej	1,749	919	830

Faza III: në QKUK për fazën e III-të bëhet zgjerimi i kapaciteteve me shtretër edhe në lamelën (krahun tjetër) të Objektivit të Mjekësisë Sportive (80 shtretër) dhe në ***ambulancat specialistike (me 110 shtretër)***.

Spitalet e Përgjithshme kanë përgatitur planin për fazën e III duke vënë në dispozicion 1,125 shtretër, prej tyre me qasje në sistemin qendror të oksigjenit 511 shtretër.

Maksimumi i shtretërve që janë vënë në dispozicion për trajtimin e pacientëve me COVID-19 në nivel të ShSKUK është 1,750, prej tyre 625 shtretër në QKUK dhe 1,125 shtretër në SP. Në këto kapacitete nuk janë përfshirë edhe shtretërit e destinuar për moshat pediatrike (gjithsejt 23 shtretër) në Klinikën Pediatrike në QKUK dhe shtretërit e destinuar për spitalizimin e grave shtatëzëna në Klinikën e Gjinekologjisë në QKUK (45 shtretër). Me këta shtretër, numri i përgjithshëm i shtretërve në dispozicion për pacientët COVID-19 kalon numrin prej 1,800 shtretërve në nivel të ShSKUK-së. Numri më i madh i pacientëve të spitalizuar që nga fillimi i pandemisë COVID-19 gjatë vitit 2021 është shënuar me **31. Gusht 2021, me gjithsej 1,284 pacientë**.


Përgjatë 2 muajve Gusht-Shtator 2021 në nivel të ShSKUK-së janë trajtuar gjithsej 4,342 pacientë me COVID-19 (prej tyre 2,269 gjatë muajit Gusht dhe 2,073 gjatë muajit Shtator 2021).

Në klinikat e QKUK-së gjatë kësaj periudhe janë trajtuar gjithsej 1,531 pacientë me COVID-19 (855 prej tyre në muajin Guhst dhe 676 në muajin Shtator) (tabela nr.10),

Në SP numri i të spitalizuarve gjatë valës Gusht-Shtator arrin në 2,811 (1,414 gjatë muajit Gusht dhe 1,397 gjatë muajit Shtator) (tabela nr.11).

Grafikoni nr. 3 paraqet numrin e pacientëve të spitalizuar me COVID-19 në Klinikat e QKUK-së gjatë muajve Gusht-Shtator 2021.

Nr i pacientëve COVID-19 të trajtuar në Klinikat e QKUK-së gjatë valës Gusht-Shtator 2021



Përveq përhapjes së shpejtë dhe shkallës së lartë të infektiozitetit, vala e muajve Gusht-Shtator karakterizohet edhe me numër relativisht të lartë të grave shtatëzëna dhe fëmijëve (moshat pediatrike) që kërkuan tarjtim spitalor. Kështu, numri i grave shtatëzëna me COVID-19 të spitalizuara gjatë kësaj vale është pothuajse 2.5 herë më i lartë se gjatë valës Mars-Pril 2021 (112 krahasuar me 48 gra shtatëzëna të spitalizuara gjatë Mars-Prill 2021). Poashtu edhe numri i fëmijëve të spitalizuar me COVID-19 gjatë kësaj vale është 2 herë më i madh se gjatë valës Mars-Prill 2021 (70 vs 33).

Tabela 10. Numri i Pacientëve COVID-19 të trajtuar në QKUK gjatë valës Gusht-Shtator 2021

		Gusht 2021	Shtator 2021	Gjithsej
1	Klinika Infektive	303	213	516
2	Objekti i QKMS (Mjekësia Sportive)	204	191	395
3	Klinika e Sëmundjve të Mushkërive	33	116	149
4	Klinikat Internistike	146	90	236
5	MIQ	39	59	98
6	Klinika Obstetrike-Gjinekologjike	75	37	112
7	Klinika Pediatrike	50	20	70
	Gjithsej QKUK	855	676	1,531

Edhe Spitalet e Përgjithshme gjatë kësaj vale sfidohen me numë të madh të pacientëve me COVID-19 që kërkojnë spitalizim duke trajtuar gjithsej 2,811 pacientë të gjitha SP së bashku.

Grafikoni nr.4 paraqet numrin e pacientëve me COVID-19 të spitalizuar gjatë valës Gusht-Shtator 2021 sipas Spitaleve të Përgjithshme.




Tabela 11. Numri i Pacientëve COVID-19 të trajtuar në SP gjatë valës Gusht-Shtator 2021

SPITALI I PËRGJITHSHËM	Gush 2021	Shtator 2021	Gjithsej
SP i Prizrenit	279	494	773
SP i Gjilanit	350	176	526
Sp i Pejës	321	269	590
Sp i Gjakovës	189	169	358
Sp i Ferizajit	112	143	255
Sp i Mitrovicës	104	113	217
SP i Vushtrisë	59	33	92
Gjithsej Spitalet e Përgjithshme	1,414	1,397	2,811

Pacientët e trajtuar me COVID-19 sipas muajve dhe njësive të ShSKUK-së gjatë vitit 2021

Sipas të dhënave të paraqitura në tabelën nr.12, në nivel të ShSKUK gjatë vitit 2021 janë trajtuar gjithsej 12,838 pacientë të infektuar me COVID-19, prej të cilëve 4,777 (37.2%) në Klinikat e QKUK-së dhe 8,061 (62.8%) në Spitalet e Përgjithshme. Numri i fëmijëve të sëmurë me COVID-19 të trajtuar në Klinikën Pediatrike është 131 fëmijë, ndërsa në Klinikën Obstetrike-Gjinekologjike gjatë vitit 2021 u trajtuan gjithsej 197 gra shtatzëna të infektuara me COVID-19.

Muaji Mars shënon muajin me më së shumti pacient të spitalizuar nga COVID-19 gjatë vitit 2021 (gjithsej 2,411 pacientë), ndërsa muaji Nëntor - muajin me numrin më të vogël të pacientëve me COVID-19 (gjithsej 111). Piku i të spitalizuarve është shënuar më 31. Gusht, me 1,284 pacientë të spitalizuar nga COVID-19 në nivel të ShSKUK-së.

Grafikoni 5. Nr i pacientëve COVID-19 të spitalizuar në ShSKUK sipas muajve gjatë vitit 2021




Tabela nr. 12. Numri i të spitalizuarve me COVID-19 gjatë vitit 2021 sipas muajve dhe klinikave/SP

		Nr. i Pacientëve COVID-19 të trajtuar në ShSKUK gjatë vititi 2021												
		Jan	Feb	Mar	Apr	Maj	Jun	Jul	Aug	Sep	Oct	Nov	Dec	Gjithsej
1	Klinika Infektive	279	184	303	244	110	30	52	303	213	35	16	9	1,778
2	Objekti i QKMS (Mjekësia Sportive)	86	113	274	191	19	0	0	209	141	0	0	0	1,033
3	Klinika e Sëmundjve të Mushkërive	80	85	172	111	32	29	6	33	116	8	23	92	787
4	Klinikat Internistike	0	0	64	194	0	0	0	146	90	0	0	0	494
5	MIQ	54	43	72	70	22	0	0	39	59	0	0	0	359
6	Klinika Obstetrike-Gjinekologjike	10	12	32	16	12	0	1	75	37	0	0	0	195
7	Klinika Pediatrike	9	10	16	17	3	3	2	50	20	0	1	0	131
Gjithsej QKUK		518	447	933	843	198	62	61	855	676	43	40	101	4,777

1	SP i Prizrenit	248	284	345	308	148	64	21	279	494	106	29	6	2,332
2	SP i Gjilanit	97	108	355	228	65	26	24	350	176	14	0	0	1,443
3	Sp i Pejës	112	106	214	227	70	19	21	321	269	18	18	6	1,401
4	Sp i Gjakovës	52	78	189	170	63	9	19	189	169	25	17	8	988
5	Sp i Ferizajit	116	113	168	154	34	4	0	112	143	34	0	6	884
6	Sp i Mitrovicës	53	36	125	153	53	14	0	104	113	21	7	6	685
7	SP i Vushtrisë	47	33	82	54	16	4	0	59	33	0	0	0	328
Gjithsej Spitalet e Përgjithshme		725	758	1,478	1,294	449	140	85	1,414	1,397	218	71	32	8,061
Gjithsej ShSKUK		1,243	1,205	2,411	2,137	647	202	146	2,269	2,073	261	111	133	12,838

Vdekjet nga pandemia COVID-19 në Kosovë

Në një analizë të bërë për numrin e vdekjeve të konfirmuara me COVID-19 në Kosovë, që nga fillimi i pandemisë në mars 2020 deri në fund të vitit 2021 (23.Dhjetor 2021) rezulton se 2,989 pacientë nuk kanë mundur t'i mbijetojnë infeksionit COVID-19.

Në tabelën nr.13 është praqitur numri i përgjithshëm i rasteve të konfirmuara të vdekjeve nga COVID-19 në Kosovë, dhe për analizë është krahasuar me numrin e vdekjeve nga COVID-19 në vendet e rajonit, në disa vende të BE, Angli dhe SHBA.

Tabela krahasimore – vdekjet COVID-19 në Kosovë, vendet e rajonit, disa shtetet të BE, Angli dhe SHBA që nga fillimi i pandemisë Covid-19 deri në fund të vitit 2021:

	Shtetet	Nr.total i rasteve të konfirmuara pozitive	Nr. total i vdekjeve	Nr. i vdekjeve në 1 (një) milion banorë
1.	B&H	286,792	13,243	4,074
2.	Mali i Zi	161,672	2,381	3,790
3.	Maqedonia Veriore	222,333	7,868	3,777
4.	Kroacia	686,590	12,179	2,994
5.	Sllovenia	453,093	5,528	2,659
6.	SHBA	52,510,978	833,029	2,495
7.	Italia	5,472,469	136,077	2,256
8.	Anglia	11,647,473	147,573	2,157
9.	Kosova	161,302	2,989	1,661
10.	Austria	1,258,377	13,595	1,497
11.	Suedia	1,273,313	15,229	1,494
12.	Serbia	1,286,025	12,488	1,438
13.	Zvicra	1,221,424	12,091	1,382
14.	Gjermania	6,918,033	110,244	1,310
15.	Shqipëria	206,616	3,180	1,107

Nga krahasimi i shkallës së vdekshmërisë të shkaktuar nga Koronavirusi në vendet e ndryshme, rezulton se numri total i vdekjeve nga Koronavirusi i shprehur në 1 milion banorë është më i ulët në Kosovë se në shumicën e vendeve të rajonit dhe disa shtete evropiane (Itali, Angli, Slloveni, Kroaci, etj.). Kështu, përderisa në Kosovë janë regjistruar 1,661 vdekje në 1 milion banorë, kjo shifër në Itali është 2,256 vdekje në 1 milion banorë; në Angli 2,157 vdekje në 1 milion banorë, në Slloveni 2,659 vdekje në 1 milion banorë, në Kroaci 2,994; Numër i lartë i vdekjeve nga Koronavirusi është regjistruar në Bosnje e Hercegovinë, në Malin e Zi dhe në Maqedoninë Veriore. Nga këto të dhëna konkludojmë se Kosova ka shkallë më të ulët të vdekshmërisë nga Koronavirusi se shumica e shteteve të rajonit dhe disa vendeve evropiane

Raporti i progresit i KE publikuar për vitin 2021 vlerëson lart menaxhimin e pandemisë COVID-19 në Kosovë. Në mes tjerash, në raport thuhet se Autoritetet shëndetësore në Kosovë kanë arritur **progres signifkant** në përmirësimin e mbikqyrjes, hulumimit & gjurmimit të rasteve dhe në menaxhimin e rasteve.

Citati; “*Health authorities in Kosovo focused mainly on management of COVID-19 pandemic during 2020-21. They achieved significant progress in improving surveillance, case investigation, contact tracing and **case management***”.

Përveq personelit shëndetësorë që kanë marrë pjesë drejtëpërdrejtë në trajtimin e pacientëve të spitalizuar, kontribut të pazëvendësueshëm kanë dhënë edhe të gjitha departamentet, sektorët dhe shërbimet tjera teknike profesionale, përfshirë riorganizimin e personelit shëndetësorë, ridestinimin e hapësirave dhe përmirësimin e infrastrukturës, furnizimet dhe menaxhimin me barëna dhe material shpenzues mjekësor, furnizimet dhe menaxhimin e paisjeve mjekësore. I gjithë ky aktivitet në nivel të ShSKUK është drejtuar nga Komiteti për ngritjen e gatishmërisë për menaxhimin e pandemisë COVID-19, si dhe nga menaxhmenti i Spitaleve të Përgjithshme dhe institucioneve tjera njësi përbërëse të ShSKUK. Gjatë kohës së valëve epidemiologjike (Mars –Prill, dhe Gusht-Shtator), ky komitet ka mbajtur takime të rregullta pothuasje çdo ditë, ndërsa gjatë periudhës së qetë epidemiologjike, mvarësisht nga nevojat për riorganizimi/rikthim të hapësirave spitalore në gjendje fillesatre.

Përveq Komitetit të sipërpërmedhur, Drejtori i Përgjithshëm i ShSKUK ka themeluar edhe dy trupa tjerë profesionalë (komisione):

- njërin për riorganizimin e personelit shëndetësorë dhe stafit jo-shëndetësorë në funksion të sigurimit të mjaftueshëm të stafit për trajtimin e pacientëve me COVID infeksion, dhe;
- komisionin tjetër për riorganizimin dhe ridestinimin e hapësirave spitalore për të siguruar numër të mjaftueshëm të shtretërve për spitalizimin e pacientëve me COVID infeksion.

Aktivitetet e Komitetit të ShSKUK për ngritjen e gatishmërisë për menaxhimin e rasteve klinike me COVID-19 në ShSKUK

Në vijim janë paraqitur disa nga aktivitetet kryesore të ndërmarra nga ana e ShSKUK-së, përmes Komitetit të ShSKUK-së për ngritjen e gatishmërisë për menaxhimin e pandemisë COVID-19:

- ✓ Përgatitja e planit dhe zgjerimi i kapaciteteve spitalore edhe në Spitalet e Përgjithshme, përfshirë shtimin e numrit të shtretërve për COVID-19, por edhe shtretërve për kujdes intensiv për nevojat e pacientëve me COVID-19;
- ✓ Pas situatës së volitshme epidemiologjike, duke filluar nga data 11. Janar, 2021 lejohen pushimet vjetore të punëtorëve të ShSKUK-së;
- ✓ Bazuar në konkluzionet e Komitetit të ShSKUK të datës 30.12.2020, programi elektiv operativ dhe ditët operative, caktohen në koordinim me Anesteziologët;

Muaji Janar dhe Shkurt 2021 karakterizohen me situatë të qetë epidemiologjike. Në fillim të Marsit fillon rritja e numrit të pacientëve që kërkojnë spitalizime

- ✓ Me përkeqësimin e situatës epidemiologjike dhe fillimin e rritjes së numrit të pacientëve të spitalizuar, klinikat internistike rrisin gatishmërinë dhe përditësojnë planin për lirim të hapësirave nëse paraqitet nevoja për kapacitete shtesë për trajtim të pacientëve me COVID-19;
- ✓ Drejtorët dhe kryeinfermieret e klinikave dhe spitaleve, obligohen të përditësojnë listat e infermierëve që kanë shërbyer në klinikat COVID dhe atyre që nuk kanë qenë fare në shërbim të pacientëve në klinikat COVID;
- ✓ Të gjithë drejtorët dhe kryeinfermieret e klinikave, spitaleve obligohen të përgjigjen në kërkesat e komisionit për caktim të infermierëve në njësitë Covid. Pa përjashtime, obligohen të përfshihen dhe të shërbejnë në klinikat dhe repartet COVID edhe kryeinfermierët e reparteve dhe klinikave. Kjo vlen për të gjithë që nuk kanë sëmundje shoqëruese dhe nuk janë të liruar nga kujdestaria;
- ✓ Klinika e Biokimisë, duke filluar nga dita e Hënë, 12. Prill 2021, të dërgojë nga një mjek specialist të biokimisë në klinikat COVID, në mënyrë që të monitorohet, mbikëqyret dhe kontrollohet procesi i marrjes së mostrave për analiza biokimike;
- ✓ Komiteti i ShSKUK-së, kërkon që të përsëritet kërkesa për vazhdim të kontratave të stafit të angazhuar për njësitë COVID nga MSh dhe Banka Botërore;
- ✓ Me qetësimin e situatës epidemiologjike, nga data 30 prill 2021 pacientët nga njësia COVID-3, (blloku internistik) transferohen në njësitë e tjera COVID në kuadër të QKUK-së. Infermierët që kanë shërbyer në këto njësi, transferohen në njësitë e tjera.
- ✓ Nga data 1. Maj 2021, lejohet sërish shfrytëzimi i pushimeve vjetore në të gjitha njësitë e ShSKUK-së, pa e dëmtuar organizimin e punës.
- ✓ Lidhur me pushimet e vitit 2019, të bëhet një analizë nga secila klinikë dhe njësi e ShSKUK-së, për ditët e pushimeve të pashfrytëzuara për secilin të punësuar;
- ✓ Specializantët e Klinikës infektive, Klinikës së Pulmologjisë, Klinikës Emergjente dhe Klinikës së Anesteziologjisë, për shkak të ngarkesës me punë në njësitë COVID, mundësisht të kursehen, mos të kyçen në punë të tjera jashtë klinikave COVID;
- ✓ 5 maj 2021: Të gjitha klinikat e bllokut internistik të fillojnë zhvendosjen nga hapësirat që ishin vendosur përkohësisht dhe të kthehen në hapësirat e tyre pasi që janë liruar nga pacientët COVID;
- ✓ 20 maj 2021: Pacientët nga Mjekësia Sportive të transferohen në njësitë tjera COVID. Stafi lirohet për kthim në klinikat e tyre;

- ✓ Për nevojat të SHSKUK-së, kërkohen 50 mijë teste rapid për SARS CoV 2- nga donacioni i shtetit të Gjermanisë, të cilin ia ka dhuaruar Ministrisë së Shëndetësisë. Prej tyre, 25 mijë për QKUK-në dhe 25 mijë për Spitalet e Përgjithshme;
- ✓ Nga java e ardhshme, takimet e Komitetit do të mbahen një herë në javë, çdo të martë nga ora 9:00;
- ✓ Të gjitha njësitë përbërëse të SHSKUK-së të përgatisin raportet për pushimet e pashfrytëzuara gjatë vitit 2020 dhe t'i dërgojnë deri më 25 maj 2021;
- ✓ 25 maj 2021: Pacientët e fundit të mbetur në MIQ (3 pacientë) të përgatiten për transferim në Repartin Intenziv të Klinikës Infektive. Ky repart të përkrahet me anesteziolog, sipas nevojës;
- ✓ Pas transferimit të pacientëve nga MIQ, të fillojë dezinfektimi i Mjekimit Intenziv Qendror, me qëllim që të përgatiten hapësirat për transferimin e Mjekimit Intenziv Qendror Traumatik.
- ✓ Kl. e Pulmologjisë dhe Kl. e Dermatologjisë vazhdojnë të shërbejnë edhe më tutje si njësi COVID;
- ✓ 15 qershor 2021: Një repart i Klinikës së Pulmologjisë bartet në Klinikën Infektive, për t.i mundësuar punëkryesit shtrirjen e rrjetit të oksigjenit qendror dhe renovimin e nyjeve sanitare në Klinikën e Pulmologjisë;
- ✓ Të vazhdojë respektimi i masave anti-Covid, sipas vendimit të fundit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në veçanti bartja e maskave nga punëtorët shëndetësorë;
- ✓ Të rritet vigjilenca në nivel të të gjitha institucioneve të ShSKUK-së, të ndalohet prania e familjarëve dhe personave të paautorizuar në institucionet shëndetësore;
- ✓ 29 qershor 2021: Kërkohet vëmendje e vazhdueshme në mundësinë e diagnostikmit të rasteve me Covid-19 në klinika, spitalet e përgjithshme dhe institucionet e tjera përbërse të ShSKUK. Obligohen klinikat dhe spitalet e përgjithshme të marrin anamnezën epidemiologjike të pacientëve të pranuar në klinika dhe spitale;
- ✓ Janë në dispozicion testet rapide në barnatoren qendrore të ShSKUK-së, prej ku klinikat dhe spitalet mund të furnizohen;
- ✓ Barantorja Qendrore e QKUK-së, të ndërmarrë masat e nevojshme për furnizim me material dhe masa mbrojtëse anti-covid për klinikat dhe spitalet e përgjithshme. Poashtu, për furnizim me barnat dhe materialin tjetër shpenzues të nevojshëm;

- ✓ Kërkohej nga Ministria e Shëndetësisë që të shqyrtoj mundësitë për stimulim shtesë për stafin që punon në njësitë COVID, bazuar në Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e COVID-19;
Pas periudhës së qetë epidemiologjike 3 mujore (Maj, Qershor, Korrik), në fillim të Gushtit fillon vala e radhës e COVID-19. Kështu, për t'iu përgjigjur kësaj vale epidemiologjike, Komiteti ndërmerr veprimet e nevojshme:
- ✓ Gjatë muajit gusht, 10 Gusht 2021, është marë vendim për rikthim të hapësirave për Covid-19 në Klinikën Infektive II (Mjekësi Sportive). Të pajiset me shtretër dhe paisjet e nevojshme mjekësore;
- ✓ Shumë shpejtë kapacitetet e Objektivit të Mjekësisë Sportive mbushen, kështu që:
- ✓ Me 19 Gusht Klinikat Internistike, ridestinohej sërish për trajtim të pacientëve me COVID-19 – Njësia COVID-III; Klinikat internistike, sipas planit të transferohen në Klinikën e ORL, Klinikën e Oftalmologjisë dhe Klinikën e Alergologjisë; poashtu gjatë ditës së sotme të lirohen edhe hapësirat e Klinikës së Dermatologjisë për të pranuar pacientët COVID-19
- ✓ Hapësirat e ish-Mjekimi Intensiv Traumatik, shndërrohen në Mjekim Intensiv COVID-19 Udhëzohen shërbimet përkatëse teknike të ndërmarrin masat e nevojshme për aktivizimin e kësaj hapësire;
- ✓ Zgjerimi i kapaciteteve me shtretër në Mjekimin Intensiv në Klinikën Infektive, nga 6 në 20, (14 shtretër të repartit E ridestinohej për shtretër intensiv; sipas nevojës do të ridestinohej edhe 14 shtretër tjerë të repartit F);
- ✓ Lirimi i hapësirave të Klinikës së Dermatologjisë që u vunë në shërbim të Klinikës së Pulmologjisë për të shërbyer për pacientë me COVID-19;
- ✓ Në Spitalet e Përgjithshme, vazhdon zgjerimi i hapësirave – ridestinimi i shtretërve për pacientët me COVID-19 në repartet përkatëse sipas planeve të veprimit;
- ✓ Shërbimi Farmaceutik ngritë gatishmërinë në nivelin më të lartë për furnizim stabil të të gjitha klinikave COVID-19, dhe Spitalet e Përgjithshme;
- ✓ Bëhet furnizimi me teste rapide për COVID-19 për të gjitha klinikat e QKUK-së dhe Spitalet e Përgjithshme;
- ✓ Sigurohen dhe bëhet shpërndarja e 700 shtretërve të rinjë në klinikat e QKUK-së dhe SP;
- ✓ Angazhimi i specializantëve për kujdestari shtesë edhe gjatë vikendeve në njësitë për trajtimin e pacientëve me COVID-19 në QKUK dhe Repartet CCOVID në Spitalet e Përgjithshme;
- ✓ Riorganizimi dhe shtimi i personelit shëndetësorë në klinikat/njësitë COVID-19 me staf nga klinikat/repartet tjera jo-COVID, përfshirë angazhimin edhe të stafit shëndetësor menaxhues të klinikave (drejtorë, kryeinfermierë të klinikave, kryeinfermierë të reparteve, etj.);

- ✓ Në takimet me drejtorët e Spitaleve të Përgjithshme, bazuar në numrin e lejuar për punësime shtesë nga Ministria e Shëndetësisë, u bë planifikimi për nevojat që kanë SP për infermier/e, ndihmës infermier/e, teknik laborantë, teknik të radiologjisë;
- ✓ Nga java e parë e muajit Shtator 2021 angazhohen rreth 600 staf shëndetësorë, kryesisht infermierë dhe rreth 150 staf jo-shëndetësorë teknik-mbështetës nga ana e MSh. Është kjo ndihmesë e pazëvendësueshme dhe e mirëseardhur në momentet më kritike për stafin e stërlodhur tashmë të ShSKUK-së që gati prej 2 viteve ishin në përballje me COVID-19;
- ✓ Respektimi i masave anti-COVID, qoftë nga personeli, apo edhe personat e tjerë, bazuar në Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë së COVID-19;
- ✓ Riorganizim i hapësirave spitalore, bazuar në nevojat e paraqitura për spitalizim të pacientëve me COVID-19;
- ✓ Reduktimi i programit elektiv të operacioneve bazuar në gjendjen epidemiologjike, ndërsa me 23 gusht pezullimi i përkohshëm i operacioneve elektive pas rritjes së numrit të pacientëve të hospitalizuar. Personeli shëndetësorë i liruar nga këto shërbime, riorganizohet në klinikat COVID;
- ✓ Redukimi i shërbimeve /vizitave në ambulancat specialistike për 50%;
- ✓ Riorganizimi dhe shtimi i 80 shtretërve shtesë në lamelën (pjesën tjetër) të objektit të Mjekësisë Sportive;
- ✓ 26 gusht 2021: Pacientët jo-Covid nga Klinika e Pulmologjisë, transferohen në Repartin A/C të Klinikës së Kirurgjisë Abdominale. Personeli i Kirurgjisë Abdominale dhe Klinikës së Kirurgjisë Torakale kujdeset për këta pacientë, dhe caktohet një specialist i pulmologjisë për këtë repart;
- ✓ Rikujtohen konkluzionet e datës 26. Nëntor 2020, lidhur me angazhimin e stafit në njësitë Covid dhe kategoritë e liruara, bazuar në diagnozat dhe listat me sëmundje kronike, të miratuar po në këtë mbledhje. (bashkëngjitur dërgohen përsëri këto konkluzione dhe lista me diagnoza me sëmundje kronike);
- ✓ Në Klinikën Infektive të fillojnë përgatitjet për zgjerim të hapësirave për Mjekimin Intensiv, në repartin më të afërt dhe të jenë të gatshme për fundjavë;
- ✓ Një repart i Klinikës së Oftalmologjisë do të përdoret bashkë me Klinikën e Otorinolaringnologjisë, për raste urgjente; Klinika e Endokrinologjisë zhvendoset një kat më lartë;
- ✓ Pacientët e Klinikës së Pulmologjisë që ndodhen në Klinikën e Kirurgjisë Abdominale, transferohen në Klinikën e Neurologjisë. Në orarin e paradites pacientët i viziton specialisti i pulmologjisë, përderisa shërbimet tjera ofrohen nga Klinika e Neurologjisë;

- ✓ Me 30. Gusht 2021 ambulancat specialistike të Klinikës së ORL dhe Oftalmologjisë përgatiten për t'u funksionalizuar për triazhim të pacientëve me COVID-19 në QKUK, dhe nga data 08. Shtator 2021 këto ambulance shndërrohen në qendër të triazhimit për COVID-19 në QKUK, të cilat shërbejnë për këtë qëllim deri në fund të muajit Shtator;
- ✓ Nga data 31. Gusht 2021, pezullohet puna në ambulancat specialistike, dhe hapësirat e tyre përgatiten për shtim të kapaciteteve me shtretër për spitalizim të pacientëve me COVID-19, në rast nevojë (plani për shtimin e 110 shtretërve në këto hapësira);

Gjatë muajve Gusht-Shtator 2021 (valës së pandemisë COVID-19), janë ndërmarre edhe një numër veprimesh të caktuara, si:


- ✓ Janë obliguar të respektojnë masat anti-Covid të parapara me Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë së Covid-19 (bartja e maskës, distanca fizike, higjiena e duarve dhe masat tjera) të gjithë vizitorët dhe palët tjera që frekuentojnë hapësirat /ambientet spitalore në ShSKUK;
- ✓ Menaxherët e njësive organizative të ShSKUK-së, obligohen që në vende të dukshme të vendosin orarin e saktë të vizitës së familjarëve për pacientë dhe orarin për dhënien e informatave.
- ✓ Të gjithë punëtorët e ShSKUK-së paralajmërohen se së shpejti mund të pezullohen pushimet vjetore, varësisht nga situata epidemiologjike me pandeminë Covid-19.
- ✓ Komisioni për organizimin e infermierëve, obligohet të implementojë planin për riorganizimin e tërë stafit infermior në ShSKUK, për njësitë Covid-19.
- ✓ Komisioni për zgjerim të kapaciteteve hapësinore në ShSKUK, në rast të rritjes së numrit të pacientëve me COVID-19, të identifikojë hapësira shtesë për zgjerim të kapaciteteve me shtretër;
- ✓ Drejtorët e Njësive organizative të ShSKUK-së, obligohen të organizojnë programin operativ elektiv në përputhje me situatën epidemiologjike aktuale.
- ✓ Për shkak të rritjes rapide të numrit të rasteve të spitalizuara me COVID-19, në nivel të ShSKUK-së, pezullohen përkohësisht të gjitha pushimet vjetore, nga dita e hënë, 23. Gusht 2021;
- ✓ Në rast nevojë për transportim të pacientëve me COVID-19 në njësitë COVID, Klinika Emergjente, angazhohet të bëjë transportimin e pacientëve.
- ✓ Urdhërohen Spitalet e Përgjithshme të rishikojnë planet aktuale dhe të përgatisin plane shtesë për zgjerim të mëtejshëm të kapaciteteve spitalore me shtretër, për trajtim të rasteve me COVID-19.
- ✓ I bëhet thirrje (ftesë) stafit për vaksinim sa më parë, duke j'u rikujtuar rëndësinë që ka vaksinimi;

- ✓ Kërkohet vëmendje më e shtuar për sigurinë fizike të objekteve, poashtu sa i përket vizitave të familjarëve në ambientet spitalore, të eliminohen hyrje-daljet e panevojshme;
- ✓ Kërkohet rritje e vigjilencës nga zyrtarët përkatës sa i përket furnizimit me oksigjen. Kërkesat të bëhen me kohë dhe zyrtarët përgjegjës të jenë në kontakt të vazhdueshëm me personat përgjegjës në ShSKUK;
- ✓ Barnatoret e Spitaleve të Përgjithshme, përkatësisht zyrtarët përgjegjës të përgjigjen në kërkesat e ShSKUK-së dhe të jenë në kontakt të vazhdueshëm me zyrtarët e ShSKUK-së. Të bëhet me kohë furnizimi me barnat bazike të nevojshme, poashtu me masat mbrojtëse për punëtorët e Spitaleve të Përgjithshme;
- ✓ Kërkohet nga Policia e Kosovës të kthejë pikat statike në njësitë Covid-19 në QKUK;
- ✓ Urdhërohen drejtorët e klinikave dhe shefat e reparteve në QKUK dhe Spitalet e Përgjithshme të lejojnë vetëm një familjar për dhënie të informatave për të cilin më parë është përcaktuar pacienti. Prezenca e palëve tjera është e ndaluar;
- ✓ Të gjithë drejtorët e klinikave dhe kryeinfermierët obligohen të dorëzojnë listat e punëtorëve, përfshirë edhe emrat e punëtorëve të liruar nga kujdestaria dhe arsyetimin për lirim. Listat dorëzohen tek komisioni për riorganizim të stafit;
- ✓ Të gjithë pacientëve që i nënhtrohen ndërhyrjeve kirurgjike, kërkohet t’iu bëhet testi rapid për COVID-19.
- ✓ Shërbimet ambulantore vitale, si ato pediatrike vazhdojnë, kurse spitalet e përgjithshme sipas mundësive dhe hapësirave vazhdojnë të ofrojnë shërbime specialistike;


Ambulancat specialistike të ORL dhe Oftalmologjisë të ridestinuara në qendër triazhimi për pacientët me COVID-infekcion



Kontrolla mjekësore dhe triazhimi i pacientëve



Platoforma elektronike e zhvilluar mundëson informata në kohë reale për vendet e lira në klinikat Covid-19



Sidat kryesore në menaxhimin e pandemisë COVID-19 në ShSKUK

ShSKUK është përballur me një numër sfidash gjatë menaxhimit të pandemisë COVID-19. Ndër kryesoret ishin furnizimi me oksigjen, sigurimi i personelit të mjaftueshëm për trajtimin pacientëve me COVID-19, ridestinimi i hapësirave – shtimi i shtretërve të mjaftueshëm për pacientët COVID-19. Megjithatë, duke pasur përvojën nga viti paraprak, dhe sidomos pas zgjedhjes së çështjes së furnizimit me oksigjen përmes vendosjes së cryo-tankeve (furnizimit e oksigjen të lëngshëm) dhe zgjerimit të rrjetit qendror të oksigjenit në disa klinika të QKUK, ShSKUK arriti që të tejkalojë sfidat e identifikuar për menaxhimin e pandemisë COVID-19. Tabela 14. përmbledh pesë (5) sfidat kryesore, të cilat u adresuan me kohë dhe për seilën prej tyre janë ndërmarrë veprime konkrete, të paraqitura në këtë raport të menaxhimit me pandeminë COVID-19 në Kosovë.

Tabela nr. 14. Sfidat kryesore të ShSKUK-së në menaxhimin me pandeminë COVID-19 në vitin 2021

Sfidat kryesore		
	Sfida e identifikuar	Koment
1	Oksigjeni	Furnizimi me bombola të oksigjenit, në mungesë të sistemit të oksigjenimit qendror.
2	Burimet njerëzore	Mungesa e infermierëve dhe mjekëve specialist për fusha të caktuara
3	Numri i limituar i shtretërve	Mungesë e shtretërve me kyqe qendrore të furnizimit me Oksigjen nëpër klinika të QKUK-së, dhe Spitale të Përgjithshme
4	Furnizimi me barna dhe material shpenzues	Buxheti i shkurtuar për ShSKUK për vitin 2021, vështirësitë në procedurat e prokurimit, pamundësia e furnizimit në kohë për shkak të gjendjes emergjente botërore shëndetësore në furnizim me produkte medicinale, mungesat e barnave të caktuara në treg.
5	Infrastruktura e Objekteve	Vështirësitë në krijimin e hapësirave adekuate për trajtimin e pacientëve të sëmurë me COVID-19, nevoja për adaptim të infrastrukturës ekzistuese

Falënderim

Pavarësisht angazhimeve dhe momenteve të vështira nëpër të cilat mund të kalojë, njeriu gjithmonë duhet të gjejë kohë për të ndaluar një moment për të falënderuar njerëzit që në çfarëdo forme dhe në çfarëdo niveli kontribuojnë në tejkalimin e sfidave me të cilat ballafaqohet. Shëndeti individual dhe kolektiv i qytetarëve të Kosovës, këtyre 2 viteve të fundit u sfidua seriozisht duke u kërcënuar nga pandemia COVID-19. Ishin mantelbardhët, por jo vetëm, ata që u gjendën në ballë të përballimit të kësaj emergjence globale shëndetësore.

Duke pasur bindjen e thellë se mantelbardhët treguan profesionalizëm, përkushtim dhe vetmohim, por edhe sakrificë në përballimin e pandemisë COVID-19, zyra e Drejtorit të Përgjithshëm të ShSKUK-së, falënderon të gjithë mantelbardhët për punën e palodhshme që kanë treguar në përballimin e sfidave të shumta përgjatë vitit 2021, në mënyrë të veçantë në përballjen me sukses me pandeminë COVID-19. Falënderime të veçanta edhe për zyrtarët administrativ, punëtorët teknik, stafin mbështetës, donatorët dhe të gjithë ata që çfarëdo forme dhe role të tjera ndihmuan në realizimin e objektivave tona.

Natyrisht, u jemi mirënjohës qytetarëve që n'a besojnë çdo ditë që të kujdesemi për shëndetin e tyre dhe të familjarëve të tyre.